


8.SH-32

GJERGJ VLASHI

V 29

MUZIKË NATE



T R E G I M E

891.P83-32

V 79

GJERGJ VLASHI

S

MUZIKË NATE

- TREGIME -

~~51067~~

POLITEKA E SHTETIT
GJAKARTA
3318

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ATË NATË BRODHA RRUGËVE

C'dreq nate të Vtitit të ri kam kaluar vitin që shkoi. Nuk do ta harroj kurrë. Të gjithë këtë festë e kalojnë të gëzuar, kurse unë... Për këtë nuk qe fajtor njeri. Vetë e bëra, vetë e pësova.

Ja, ç'më ndodhi.

Me tridhjetë e një dhjetor u ktheva nga udhëtimi pasdite. Lashë maqinën në park, ndenja ca me shokët dhe xha Rakon në klub duke i uruar plakut para kohe Vtin e ri, se ai atë natë ishte roje, pastaj u ndamë. Kalova nëpër rrugët e qytetit të mbushura me turma njerëzish si asnjëherë tjetër. Dyqanet ishin plot me blerës, sa nuk kishe ku të hidhje kokrrën e mollës. Rrugës nxitën njerëz me pakon ndër duar, me çanta e rrjeta të mbushura kapicë, që i thërrisin njerëzi tjetrit:

— Gëzuar Vtin e ri!

Këtë urim e gjeje të shkruar nëpër mure, në pullazin e komitetit ekzekutiv, në vitrinat e të gjitha dyqaneve:

— Gëzuar!

Më të gëzuar nga të gjithë ishin fëmijët, që capiteshin me pakot e lodrave ndër duar. Disa që

nuk duronin dot, i kishin hapur pakot dhe donin t'i shikonin. Ndonjëri shtynte në trotuar maqinën, lokomotivën apo rrulin që shtron rrugët. Duke shikuar anash, nuk vura re dhe i shtypa maqinën një fëmije. Ajo ishte një skodë e vogël jeshile, që unë, shoferi i skodës së madhe, ja shkela me këmbë. Fëmija, që mund të ishte nga gjashtë vjeç, zuri të qajë. E ëma u mundua ta largojë. Po dëgjonte ai. M'u avit dhe m'u shkreh.

— Dua kamionin!

— Më fal, mor djalë, por nuk e pashë.

— Dua kamionin. Ti ma prishe, dhe tani më jep kamionin tënd!

— Ai është shumë i madh, — i thashë unë dhe zura të qesh.

Ai u nxeh dhe sytë i shkëlqyen nga lotët. E ëma e tërhiqte, po ai nuk shkulej. E mora pér dorë dhe hymë bashkë në një dyqan, Aty i bleva një lodër tjetër, se maqina nuk kishte. Kur u ndamë, i tregova se isha shofer dhe i dhashë fjalën se do ta hypja në kamionin tim të madh.

Fëmija u largua i gjëzuar dhe atë natë ndoshta ka ëndërruar udhëtimin me kamionin e një xhaxhi, të cilit nuk ja dinte as emrin.

Porsa hyra në shtëpi, vura re se çdo gjë ishte gati dhe të gjithë më pritën me thirrje të gjëzuarë e përqafime. Katër vajzat e mia ishin të veshura me fustanet e reja dhe rrinin si të ngrira, duke patur kujdes që mos t'i ndynin apo t'i rrudhnnin. Vetëm Benin e pashë që rrinte i ngrysur. Ai kishte filluar ta donte shumë gjelin e detit që kisha blerë para tri javësh dhe, atë ditë, kur e kishin therur dhe e kishin çuar në furre, ishte dëshpëruar shu-

më. Sytë e tij ishin të skuqur nga lotët. Gruaja më tha se Beni atë natë ishte betuar që mos ta fuste në gojë mishin e gjelit të detit. E mora në krah dhe zura t'i tregoja për udhëtimin e asaj dite. Ai u qetësua, megjithatë prapë u betua se mishin e gjelit të detit atë natë nuk do ta fuste në gojë.

— Ende nuk ka ardhur Rifati? — e pyeta gruan.

— Jo, por nuk do të vonohet.

U lava dhe vesha këmishën e pastër. Pastaj shkova u shtriva në divan. Isha i lodhur. Atë ditë kisha udhëtar shtatë orë. Mbylla sytë, duke shjuar qetësinë e shtëpisë dhe atë atmosferë festë që ndjehej kudo. Jashtë dritareve, nëpër shkallët e pallatit dëgjohej zhurmë, thirrje, zëra të gëzuar dhe herë pas here urimi:

— Gëzuar Vitin e ri!

Pas pak fishkëlleu lokomotiva dhe në stacion erdhi treni i fundit. Zura të dremisja. Mendoja për djalin, të cilit pa dashje i shtypa maqinën e vogël. Përfytyroja udhëtarët e trenit të fundit: nëpunës, studentë, ushtarë, që me pako e valixhe ndër duar nxitonin nëpër rrugë për ta festuar Vitin e ri në shtëpi. M'u kujtua xha Rakua, që atë natë ishte roje atje në hyrje të parkut.

Më zgjoi trokitja e derës. U ngrita. Salloni u mbush me zëra. Kishte ardhur Rifati me gruan dhe me vajzën e madhe. Ai punon si kryeinfermier në spitalin e qytetit, kurse e shoqja është mësuesse. Pse ta fsheh, nuk e kam shumë për zemër atë njeri, po është vëllai i gruas dhe duhet ta duroj, të rri me të e madje edhe të pi e të qesh. Është njeri pa lezet, i shpëlarë dhe egoist. Mjafton të jetë mirë ai dhe familja e tij. Për të tjerët nuk

bëhet fare merak. E kam vënë re disa herë këtë. Ja kam thënë edhe gruas, megjithëse ajo nuk e pranon.

Pasi biseduam ca pér gjëra të përgjithshme, zumë vend rrreth tryezës që ishte shtruar në mes të dhomës.

— A fillojmë? — thashë unë.

— Unë nuk kam asnje kundërshtim, — u pér gjegj gruaja e Rifatit duke rregulluar flokët që, siç duket, atë natë i kishte bërë permanent.

— Kur nuk ka kundërshtim gruaja, as unë nuk kam, — tha Rifati. — Tani duhet të jemi dakord me gruan se është emancipimi, — shtoi duke qeshur. Në dhomë u dëgjua vetëm zëri i tij. Të tjerët sa bënë buzën në gaz, sa pér njerëzillëk. Rifati e ka këtë të mirë, qesh vetë me shakatë që thotë.

Filluam të pimë. Të gjithë ishim të gëzuar. Biseda u gjallërua. Luljeta, vajza ime e vogël, zuri të recitojë vjershat që kishte mësuar në kopësht. Ngatërronte ndonjë fjalë, disa nuk i shqiptonte mirë dhe ne shkuleshim së qeshuri. Edhe Beni qeshi vetëm nja dy herë por vetëm një çast, se pastaj i kujtohej gjeli i detit dhe ngrysej në fytyrë. Dy vajzat e mia të mëdhaja bashkë me vajzën e Rifatit shikonin njëra-tjetërën dhe s'e përmbanin gazin. Sabajeti, gruaja ime, shkonte e vinte nga kuzhina në dhomën ku qemë shtruar.

Nga ora dhjetë e gjysmë (besoj se aq duhej të ketë qenë) trokiti dera. Kush mund të ishte në atë kohë. E hapi Sabajeti dhe pas pak në dhomë hyri Sotiri, një shofer i parkut tonë, i cili e ka shtëpi-në përballë meje, në anën tjetër të rrugës.

— Urdhëro, Sotir, — i thirra i gëzuar. Por, menjëherë vura re se ai nuk kishte ardhur pér

vizitë. Qëndroi më këmbë, i veshur me xhupin e tij që përdor kur udhëton dhe më tha:

— Erdha të të marr ty, Vehab. Tani më thanë se duhet të shkojmë në park. Më porositën të të njoftoj edhe ty.

Në dhomë u bë qetësi. Shikova Sotirin, se pan-deha që ai tallej. Sabajeti rrinte mbështetur në derën e kuzhinës. Rifati mbushi një gotë dhe ja zgjati Sotirit.

— Pije një herë këtë gotë, or shok, pa puna aty është, se nuk ka këmbë që të ikë — dhe prapë qeshi. Asnjëri nuk iu përgjegj. Sotiri bëri sikur nuk e dëgjoi dhe më tha:

— Duhet dërguar qymyrguri në minierën e malësisë. Duhet dërguar urgjentisht, përndryshe mund të shuhet furra e shkrirjes. Nga parku ynë duhet të shkojnë pesëmbëdhjetë kamiona.

— Kur duhet të nisemi? — e pyeta unë.

— Që tani.

Rifati ngriti edhe një herë gotën, pastaj fshiu buzët e trasha me pëllëmbën e dorës dhe, duke ngulur pirunin në pjatën e mezeve, tha:

— Ku e paskan gjetur sonte, pikërisht natën e Vtitit të ri!

Pse ta fsheh, sikur nuk më erdhi mirë për atë detyrë të papritur. Gjithë vitin kisha punuar me mish e me shpirt, ditë e natë mbi timon, kisha kryer të gjitha detyrat që më ishin ngarkuar, sado të rënda që kishin qenë. Po edhe natën e Vtitit të ri...

Sotiri e kuptoi se unë po lëkundesha, dhe më tha:

— Është e rëndë të lësh shtëpinë dhe mos ta

festosh Vitin e ri. Po ta përsëris: është një rast i jashtëzakonshiëm. Oxhaku i minierës ka rrezik të shuhet. Rruja ka qenë e zënë nga bora, dhe atyre u janë mbaruar rezervat. Sot njoftuan se rruga u hap, prandaj duhet dërguar menjëherë qymyri.

Unë prapë nuk fola. Po mendoja. Nuk vendosja dot. Desha të ngrihesha, po nuk luajta nga vendi. Pastaj ai i mallëkuari Rifat përsëri zuri të flasë:

— Hajt, mor Vehab vëllai, mos u bëj merak dhe mos hyr në të thella. Parku ka plot shofera të tjerë. Nuk është e domosdoshme të shkosh ti pikërisht. Ky shoku t'u thotë që ti nuk ishe në shtëpi, se e festoje Vitin e ri te kunati dhe pikë. Hajt, ngrije gotën dhe mos e vrit mendjen! Gëzuar!

Mori gotën dhe i ra gotës sime. E ngrita dhe e piva me fund.

— Merr meze, — tha Rifati i kënaqur.

Nuk i vura veshin. Shikoja përpëra meje dhe nuk vendosja dot. Se ç'dreqin pata në ato çaste as tani nuk jam në gjendje ta them. Por sidoqoftë atë kohë më erdhi mirë të rrija aty rreth tryezës së mbushur plot, pranë zjarrit që bubullonte gëzueshëm, bashkë me gruan e fëmijët e mi. Them një herë se ashtu qe vërtet, mirëpo shpesh mjaf-ton një çast, vetëm një çast...

Sotiri e kuptoi se unë nuk isha i gatshëm për atë detyrë, prandaj e preu shkurt:

— Hë, do të vish apo jo?

Prapë ndërhyri ai dreq Rifati. I tha Sotirit:

— Mor shok, disa gjëra kuptohen pa shumë fjalë. Më duket se Vehabi ta dha përgjegjen.

Prapë ngriti gotën duke e përplasur me timen. Unë nuk e ngava me dorë. Shikova Saba-

jetin. Ajo rrinte gjithnjë mbështetur tek dera e kuzhinës dhe më shikonte me sytë e saj të mirë. Edhe vajzat e mia më shikonin. Edhe Beni.

Nuk e di sa zgjati ajo heshtje. Besoj një çast, vetëm një çast, por ai çast...

Sotiri nuk e zgjati. U kthyte nga erdhi dhe, pasi tha një «natën e mirë» nëpër dhëmbë, doli nga dhoma. Asnjëri nuk foli. Dëgjuam hapat e tij tek zbriste shkallët, pastaj u bë qetësi.

Zumë prapë të hamë e të pimë duke u përpjekur ta gjallërojmë mbrëmjen por ishte e kotë, diçka ishte prishur, diçka ishte thyer tek të gjithë, me përjashtim të Rifatit. Të gjithë e ndjenim këtë, sidomos unë. Disa herë u mata të ngrihem, të ndjek Sotirin, t'i them se ai qe vetëm një çast, por prapë nuk lëviza nga vendi. Shikoja herë pas here orën pa ditur përsë. E kisha mendjen tek shokët. Tani ata me siguri ishin mbledhur, kishin ndezur maqinat dhe pasi t'i kishin ngarkuar, do të niseshin për në minierën në malësi, që oxhaku i saj mos të shuhej.

Sabajeti e kuptoi përpara të gjithëve brenëgën time. Duke sjellë një pjatë me fruta, m'u avit e më tha ngadalë:

— Je mërzitur?

Tunda kokën duke u përpjekur të vë buzën në gaz. Ajo është e para që e kupton kur jam i mërzitur, kur puna më ka shkuar mbarë ose kur jam zënë me ndonjërin.

Duke më parë ashtu edhe fëmijët e mi u bënë të heshtur. Vajzat nuk qeshnin më me njëratjetrën. Benin po e zinte gjumi. Vetëm Rifati me të shoqen nuk e kishin prishur fare terezinë.

— Ç'ke, mor Vehab, që rri sikur të janë mby-

tur gjemitetë? Ti je shofer dhe nuk ke punë me gjemitetë — tha, dhe qeshi për shakanë që bëri. — Hajde, ngrije gotën, se gjysma e mijës pesëqinë është. Mos u mendo shumë, se do plakesh para kohe.

U ngrita nga tryeza dhe shkova në dritare. Jashtë në rrugë rrallë kalonte ndonjë njeri. Të gjitha dritat e shtëpive ishin të ndezura dhe nga do dëgjohej muzikë dhe zëra. Nata ishte e kthjetëllët por e ftohtë. Qielli pa asnjë re. Vetëm bri i hënës ndriçonte i mërzitur e i vëtmuar në hapësirë. Shikova apartamentin e Sotirit. Edhe ai ishte i ndriçuar. Pas xhamit m'u duk se pashë disa hije që lëviznin nëpër dhomë.

— Dërgoi fëmijët të flenë, — i thashë gruas pa kthyer kokën.

— Duam të rrijmë derisa të vijë Viti i ri, — kundërshtuan ata.

— Unë kam fjetur në drekë. Do të rrij se nuk kam gjumë, — shtoi Beni me zërin e tij të përgjumur.

Nuk fola më. Edhe ato fjalë kot i thashë. Nuk kishte asnjë rëndësi për mua a shkonin apo nuk shkonin fëmijët për të fjetur. Nuk kishte rëndësi asgjë, as festa e Vtit të ri. Më pllakosi një mërzi, që nuk di si ta them. As shtëpia nuk më nxinte më.

Papritmas u ktheva dhe dola në korridor. E ndjeja se të gjithë po më shikonin. Punë e mëdhe. Vesha pallton dhe mbështolla shallin e lesh-të rrëth qafës.

— Po shkoj në park, — thashë duke rrasur kasketën mbi ballë.

— Tashti? — tha Sabajeti.

— Po. Ndoshta ata nuk janë nisur... Mund që janë nisur... sidoqoftë nuk më rrihet më në shtëpi.

Vura re se Rifati u mat të thotë diçka, po unë u ktheva shpejt dhe u nisa të dal nga shtëpia. Kur po mbyllja derën, dëgjova se ai diçka tha dhe, si zakonisht, qeshi vetëm. Zbrita shkallët me një frymë.

Rrugët ishin të qeta dhe rrallë kalonte ndonjë çift ose grupe tre-katër vetësh që zhdukeshin nëpër hyrjet e pallateve. Por qyteti ishte zgjuar. Të gjitha dritat të ndezura. Pas dritaresh dëgjohej muzikë, të qeshura, tringëllima gotash. Unë nuk shikoja asgjë, vetëm ecja me hap të shpejtë. E dija se po shkoja kot në park se ata me sigrui ishin nisur, megjithatë një forcë që s'e kuptoja as unë se ç'ishte, më shtynte përpara si një erë e fuqishme.

Në park ishte qetësi. Asnjë lëvizje. Asnjë zhurmë. Vetëm barakja e rojtarit plak ishte ndriçuar dhe nga oxhaku dilte tym. Kur u afrova, ai u ngrit nga vendi dhe, pasi më njoihu, më tha i habitur:

- Hë, mor Vehab, si është puna?
- U nisën ata?
- Si the?
- U nisën kamionat që do të shkonin në minierë.

— Aha, posi. Kanë gati një orë.

Nuk folëm më. Qëndruam aty para barakës së vogël të heshtur. Plaku kishte hedhur krahëve

kapotën e tij ushtarake. Ai e kuptoi se unë diç-ka kisha dhe më tha:

— Eja të rrjmë ca, o Vehab!

U ula pranë sobës dhe shtriva duart drejt zjarrit.

— Hiqe pallton, — tha plaku pas pak.

Unë nuk fola. Qëndrova me duart e ndera drejt zjarrit, po ato nuk më ngroheshin. Ishin të ftohta.

— Sa ishin ata? — e pyeta.

Plaku ngriti kokën dhe më shikoi.

— Shoferat, po të pyes, sa ishin?

— Aha, më duket pesëmbëdhjetë.

Në rrugë kaloi me të shpejtë një gaz. E njo-ha nga zhurma e motorit. Dëgjova rrotat që fër-koheshin mbi asfalt duke nxjerrë një fishkëllimë të lehtë.

— Edhe Sotiri ishte me ta, apo jo? — e pyeta prapë.


— Sotiri? Aha, ai me mustaqe të mëdha? Po, ishte. Erdhi më vonë se tjerët bashkë me Eqe-remin.

E kuptova se pas bisedës me mua, ai kishte shkuar dhe kishte thirrur Egeremin për të zënë vendin tim.

— A do të hash gjësendi? — më pyeti plaku dhe më zgjati një portokall.

— Jo, xha Rako. Nuk dua. Jam i ngopur.

Aty, në barakën e rojtarit, me duart e ftohta të ndera drejt zjarrit, mendoja për shokët që ishin nisur. Më dukej sikur e shikoja varganin e kamionave që çante errësirën dhe ngjitej nëpër



malet e heshtura, të mbuluara me borë për të çuar qymyr në minierë. Të gjithë, pa u menduar fare, kishin ndërprerë festën, kishin lënë gratë, fëmi-jët, të gatshëm, si ushtarët në front, kishin veshur xhupat e punës, kishin rrasur kasketat, ishin nisur dhe tani shtrëngonin timonin dhe çanin rrugët e bardha të malësisë.

Mesnata më gjeti aty, në barakën e xha Rakos, aty në hyrje të parkut, pranë kamionit tim, që nuk ishte nisur me të tjerët.

Ushtuan sirenat e lokomotivave dhe xha Rakuva, duke më shikuar me ata sytë e tij të qetë, më tha:

— Epo gjëzuar Vitin e ri, o Vehab!

— Gëzuar, xha Rako!

Plaku e kishte kuptuar brengën time, mbase ai e dinte se unë atë natë isha shkëputur nga shokët, megjithatë nuk më foli fare për atë gjë, nuk më pyeti. Edhe pas pak, kur u ngrita për të ikur, ai nuk tha asnje fjalë vetëm më shikoi dhe tundi kokën.

Zura të ecja nëpër qytet. Ku të shkoja? Në shtëpi nuk doja të kthehesha. Se si më vinte. Rrugët papritmas ishin gjallëruar, dhe njerëzit trumba-trumba shkonin tek njëri-tjetri për të uruar menjëherë Vitin e ri. Disa këndonin, të tjerë thërrisin e qeshnin me zë të lartë. Në të katër anët ushtonin radiot e dëgjoheshin tringëllima gotash. Vetëm unë endesha rrugëve fillikat. Të tjerët ishin të gjëzuar, pranë njëri-tjetrit, kurse unë bridhja i brengosur. Edhe pesëmbëdhjetë shokët e mi, që udhëtonin, ishin të bashkuar dhe të gjëzuar se po kryenin atë detyrë të rëndësishme pikërisht natin e Vitit të ri.

Njerëzit kalonin pranë meje. Ndonjëri më shikonte i habitur. Ndonjë tjetër thërriste:

— Gëzuar Vitin e ri!

Eca tutje nëpër rrugët e qytetit të mbushura me njerëz, me zëra, me muzikë. Kalova shezin që llamburiste nga dritat. Vitrinat ishin të mbushura me pambuk dhe me tabela, ku shkruhej:

— Gëzuar Vitin e ri!

Eca tutje, u futa nëpër rrugë të tjera dhe tërë atë natë brodha nëpër qytet, ndërsa Sabajeti më priste në shtëpi, ndërsa shokët e mi udhëtonin në rrugët e bardha, ndërsa ai djali i vogël të cilit i shtypa maqinën ëndërronte për udhëtimin që do të bënte me maqinën e madhe të një xhaxhi të panjohur.

MUZIKË NATE

N jë copë rrugë ecën pa folur. Aktorja ishte e lodhur. Tërë ditën kishte xhiruar dhe i dhim-bnin këmbët. Edhe sytë i digjinin nga dritat e forta të prozhektorëve. Ajo shikonte e habitur si ec-te plaka me hapa të mëdhaja duke shkelur e sigurtë kaldrëmin, pa dhënë asnje shënjë lodhjeje.

Rrugicat e gjata të qytetit të lashtë ishin të qeta. Shtëpitë me dritare të shumta ngriheshin të heshtura në të dy krahët. Ç'do gjë ishte e çuditshme në atë qytet, edhe rrugët, edhe shtëpitë, edhe qielli, dhe heshtja.

Ajo kishte disa javë që xhironte e prapë nuk ishte mësuar në atë qytet, që nuk ja gjeje shokun në tërë vendin tonë. Ajo e ndjente se qyteti kishte diçka të thellë, të stërlashtë, diçka të vetën që nuk e zbulojë dot as brenda disa javëve, as ndoshta brenda muajve apo viteve.

Duke ecur, vajza shikonte shtëpitë, rrugët, fenerët që ndriçonin nëpër qoshe, kalanë e zezë si një re shiu, malet përballë dhe fshatrat e ndri-

çuara nga dritat elektrike, që ngjanin si grushte me xixëllonja të shpërndara në faqe të malit.

— A u lodhe, moj bijë?

— Jo, nënë.

— Edhe pak do të mërrimë.

Zakonisht të rejat e plakat i drejtohen një-ra-tjetrës me fjalët «nënë» e «bijë». Në raste të tjera kjo gjë nuk duket e çuditshme dhe nuk të bën përshtypje, por në rastin e plakës dhe të aktoreve ndryshonte puna. Ato ishin njohur atë pas-dite. Ja si kishte ndodhur.

Do xhironin skenën e ikjes së heroinës nga shtëpia. Regjizori po i shpjegonte aktoreve se personazhi që ajo interpretonte, porsa dëgjon trokitjet e forta në derë, e kuption menjëherë se janë gjermanët dhe është e preqatitur për këtë. Shkon në dhomën e saj, merr disa dokumenta të rëndësishme që i ka fshehur aty, pastaj hidhet nga dritarja në një çati që ka pranë për të ikur sipër çative të shtëpive të lagjes, që janë të ngjitura njëra me tjetrën. Vali (kështu quhej heroina) nuk ishte personazh i krijuar nga fantazia e skenaristëve, por një vajzë e thjeshtë e atij qyteti të çuditshëm, që kishte luftuar dhëmb për dhëmb me armiqjtë, derisa kishte dhënë jetën për çlirimir e atdheut. Aktorja e kishte të vështirë t'i jepte jetë asaj figure të dashur, që gjithë njerëzit e qytetit e ruanin të gjallë në kujtesë. Ajo përpiquej të zbulonte tiparet e heroinës, por e ndjente se i mbetej shumë për të bërë.

Pasi u shuan prozhektorët dhe teknikët po zbërthenin kameran, aktorja e mërzitur hoqi gri-

3318

17
BIBLIOTEKA E SHIFTER
BULGARIJA

54067

min dhe zuri të zhvishej. Atë çast kishte dëgjuar regjisorin që e thirri. Duke u kreher doli nga dhoma e vogël ku po ndërronte rrrobot dha shkoi tek ai.

— Lola, njihu me këtë nënë!

Ajo pa pranë regjisorit një plakë eshtake, me fytyrë të zgjatur e me sy të gjallë. Plaka e shikon-te me vëmendje dhe sytë i shkëlqenin.

I dha dorën plakës pa kuptuar asgjë.

— Kjo është nëna e Valit, — tha regjizori dhe priti të shikojë përshtypjen që do t'i bënин ato fjalë aktores.

Lola u trondit dhe gati nuk u besoi syve. Shikoi plakën sikur kishte para vetes një njeri të jashtëzakonshëm. Nëna e dëshmores rrinte e heshtur.

— Ashtu! — belbëzoi vajza dhe pas pak shtoi, — gëzohem shumë. Si jeni...

— Desh t'i thotë «nënë», por e përbajti vreten. Kushedi si do të tingëllonte atë çast ajo fjalë.

— Nëna ka qenë në Tiranë tek djali i saj i martuar. Sot, porsa u kthyte, erdhi të shohë si shkon xhirimi i filmit.

Pas këtyre fjalëve të regjisorit, u bë një heshtje e rëndë. Asnjeri nuk foli. Përreth kalonin teknikët duke larguar aparaturat dhe dy elektricistë që bënин fjalë për një llampë të thyer. Lola ishte ende e tronditur. I dukej vetja sikur ishte zënë në faj, sidomos atë ditë që nuk i kishte vajtur puna mbarë. Ajo e dinte se nëna e heroinës, rolin e së cilës interpretonte, ishte gjallë dhe ndonjë ditë do të takohej me të, megjithatë njojja i erdhë fare e papritur dhe e tronditi.

Heshtja zgjati disa kohë. Të tre rrinin si në gjëmba. Pastaj regjizori i bëri disa pyetje plakës, ajo u përgjegj dhe kështu biseda rrrohë e qetë dhe e natyrshme. Para se të ndaheshin, plaka i tha Lëlës:

— A po vjen tek unë sonte?

Aktorja ktheu kokën e habitur dhe tha:

— Tek ju?

— Po, në shtëpinë time. Banoj vetëm. Aty do të të tregoj plot gjëra për Valin, dhe ti vetë do të shohësh dhomën e saj, plaçkat që ja kam ruajtur me kujdes.

Në këtë mënyrë u vendos ajo punë dhe Lola nuk pat kohë të hapë gojë. Jo se ishte kundra, por se si i vinte... Ajo druhej se kushedi si do ta kalonte atë natë... kushedi çfarë emocionesh do të provonte. Megjithatë të rrinte një natë në shtëpinë e heroinës, me nënën e saj, i dukej gjë e bukur.

Me këto mendime e me këto ndjenja në zemër, Lola po përshkonte rrugët e qytetit, që atë natë i dukeshin ndryshe nga herët e tjera.

— Shtëpia është pas asaj kthese, — tha plaka.

Lola desh t'i thotë «e di» por heshti. Gjithë rrugës gati nuk hapi gojë. «Nuk bëj mirë që hesht» tha me vete, «ndoshta plaka mund të mendojë se nuk jam e kënaqur që po kaloj këtë natë bashkë me të.»

Pasi bënë disa hapa, aktorja e pyeti sa përtë thënë diçka:

Gjithmonë këtu keni banuar?

— Jo. Më parë kemi qenë në një barakë. Aty jam martuar, aty lindi edhe Vali. Burri im ishte murator dhe tërë jetën ndërtoi shtëpi përtë tje-

rët. Në fund vendosi të bëjë një strehë për vete. Me shumë mundime ndërtoi shtëpinë që kemi sot. Por ç'e do, ai nuk e gjëzoi dot se dy muaj pasi e mbaroi vdiq. I kishte mushkëritë të dobëta dhe gjithnjë kollitej. Kur kthehej në shtëpi, unë e njihja jo nga zhurma e hapave por nga kolla e tij që ushtonte në rrugicën tonë.

Pasi mbërritën para shtëpisë, ngjitën tri këmbë shkallë dhe plaka hapi derën me një kyç të madh të lidhur pas shamisë.

Shtëpia kishte një kundërmim të çuditshëm, që ishte vështirë ta përcaktoje. Pasi ndezi drithën, plaka eci përpara dhe qëndroi në mes të korridorit:

— U bë një muaj që mungoj. Më duket sikur jam larguar prej shumë kohe.

— Pse nuk jeton më me djalin? — e pyeti Lola, që nuk e kuptonte dot si mund të rrinte vetëm në atë shtëpi të heshtur ajo plakë gjash-tëdhjetëvjeçe.

— Si ta them... nuk më bën zemra të lar-gohem. Djalit i ra goja duke më thënë që të shkoj në Tiranë dhe të jetoj me ta por, ja që unë nuk vendos dot. Eh, moj vajzë! Si i thonë fjalës, guri i rëndë në vend të vet. Me këtë shtëpi janë lidhur shumë gjëra, kujtimi i Petros, i Valit, dhe...

Pa mbaruar mirë fjalën, ajo lëvizi nga vendi dhe zuri të ecë. Qëkur ishte njohur me të, Lola kishte vënë re se ajo grua e motshme ishte e fortë. Ajo kishte dëgjuar se gjatë luftës, kur i kishte vdekur vajza e vetme, plaka kishte mbajtur kokën lart dhe, megjithëse e plagosur rëndë në shpirt, askush nuk kishte dëgjuar ndonjë ankim nga goja e saj dhe nuk kishte parë që t'i ndritnin sytë nga

lotët. Edhe tanë Lola vuri re se plaka, porsa përmendi të shoqin e Valin dhe e ndjeu se mund të mallëngjehesh, lëvizi menjëherë nga vendi dhe të dyja hynë në dhomën e zjarrit. Dhoma ishte e gjerë, e lartë, e shtruar me qilima e **me shilte**. Në mes, pranë murit, ishte oxhaku i madh me një kandil të vjetër përsipër. Aty çdo gjë ishte e pastër dhe në vend të vet.

— Ulu, — tha plaka.

Lola ndenji tek praku dhe e habitur po shikonte dhomën. Ajo ishte aktore dhe përpinqej të vërente çdo gjë me kujdes.

Plaka e pa se Lola nuk po hynte brenda, asaj diç iu kujtua dhe pasi i shkoi pranë, i tha:

— Më thotë mendja se ti më parë do të shikosh shtëpinë, dhomën e Valit dhe teshat e saja apo jo? Mirë, eja të shkojmë!

Pa i lënë kohë që të përgjegjej, plaka doli nga dhoma e zjarrit dhe zuri të ngjisë shkallët që të çonin lart. Lola e ndoqi dhe dëgjoi se shkallinat e drunjta përkuleshin nën peshën e hapave duke nxjerrë zëra të ndryshme. Asaj iu duk sikur po shkelte sipër një tastiere të madhe. Zhurmat u përhapën në tërë shtëpinë dhe papritmas u duk sikur ajo u gjallërua.

Pasi ngjitën shkallët, hynë në një dhomë të vogël me një dritare në mes të murit përkundrejt derës. Lola e kuptoi pa thënë gjë plaka se ajo ishte dhoma e Valit. E kuptoi më parë edhe fotografinë e saj të varur në mur, pa parë librat sipër komodinës pranë shtratit, pa parë ato dy fustane të thjeshta prej basmeje të varura në mur e të mbuluara me gazeta.

Kur mbërriti në mes të dhomës, aktorja ktheu kokën dhe sytë e saj u ndeshën me sytë e qeshur e të zgjuar të Valit, që e shikonin nga fotografia.

— Këtu flinte — tha plaka pa kthyer kokën. Dukej sikur fliste me vete. Iu afrua shtratit të thjeshtë prej hekuri dhe uli cepin e ngritur të batanies bojë kafe. Pastaj shkoi tek dritarja dhe lëvizi perden e bardhë.

— Kur trokiti dera, Vali ishte poshtë. E kuptoi se ishin gjermanët, u ngjit me një frymë lart, mori diçka që kishte fshehur poshtë shtratit, hapi dritaren dhe kërceu

Plaka, duke folur, hapi fletët e dritares. Lola shkoi jashtë. Në krah të djathë, pranë dritares, ishte çatia bojë hiri e shtëpisë fqinjë. Pas asaj vinte një tjetër dhe çatitë ndiqnin njëra-tjetrën si shkallina të mëdha, që atë natë të kthjellët prilli hëna e plotë i lyente me një dritë të ëmbël ar gjendi. Lola ndjeu se u ngashërye dhe i rrahu zemra.

«A të fle këtu sonte?» mendoi papritmas. Desh t'ja thotë plakës këtë dëshirë, por nuk hapi gojë. Mendoi se asaj mund të mos i vinte mirë, ndoshta edhe ajo vetë do të tronditej, sepse... «Unë nuk do të them gjë» mendoi Lola, «le të vendosë ajo vetë».

— Po shkoj të pregatis darkën, — tha pas pak plaka me zë të ulët. Qëndroi një çast në vend dhe shtoi: — Ti, po të duash rri këtu.


Doli nga dhoma. Lola dëgjoi hapat e saja që shkelnin mbi shkallinat. Pastaj sesi përshkoi sallonin dhe ndjeu zhurmën e derës së dhomës së zjarrit, që u hap e u mbyll. Sa shtëpi e çuditshme: kudo të ndodheshe e kuptoje ku shkonte

ai tjetri, në cilën dhomë hynte ose dilte. Sa zhurma, sa zëra kanë shtëpitë e vjetra. Ato janë si kutiza që ruajnë zhurmat dhe zërat e çdo viti, të çdo stine, të çdo njeriu që ka banuar aty.

Lola në fillim u tremb nga vëtmia. Hodhi shikimin përreth dhe prapë sytë e saj u ndeshën me sytë e Valit, që e shikonin të qeshur që nga fotografia. S'dinte ç'të bënte ku të ulej, çfarë të shikonte. Më në fund u ul në një fron të vjetër pranë shtratit. Atë çast fryu era e natës dhe tun-di perden e dritares, që u mufat si veli i një barke dhe e mbuloi aktoren. Ajo nuk lëvizi. Zgjati dorën dhe nga komodina mori një fletore. E hapi. Ishte një fletore shënimesh. Lola vuri re shkrimin e bukur, të kujdeshëm të Valit. Fletorja ishte e pastër, pa asnje njollë. Lola fërkoi kapakun e trashë dhe zuri të lexojë. Ato ishin shëнимë të ndryshme nga mësimet dhe aty-këtu disa mbresa të gjimnazistes së re. Asaj i bënë përshtypje disa fraza kushtuar 28 nëntorit dhe përshkimi i figurës së Skënderbeut.

Pas fletores, Lola shikoi librat që ishin aty mbi komodinë. Gati të gjitha ishin tekste shkolle. Ne mes të tyre ishte një kopje e «Vilhelm Telit» mbushur me shënimë dhe e nënvizuar gati për çdo faqe.

U ngrit nga froni. Eci pak nëpër dhomë. Iu afroa njërit prej fustaneve të varura në mur. Ai ishte i pastër, i pazhubrosur dhe dukej sikur ishte hequr një ditë më parë nga trupi i saj. Pranë tij vuri re një gjë që deri atë çast nuk e kishte parë: ishte një mandolinë me të tëra telat në vend. Dukej se Vali ishte marrë edhe me muzikë. Por-sa e pa mandolinën, Lolës iu duk se papritur dho-



ma u mbush me tinguj e akorde tē ēmbla, që u pérplasën nēpér mure, pastaj dolën nga dritarja e hapur dhe u endën sipér pullazeve tē hirta tē shtépive si një muzikë nate...

Shkoi pranë dritares. Mbushi mushkëritë me ajrin e kulluar tē asaj nate tē qetë pranverore. Në shpirt i kumbonin pareshtur ata tinguj tē ēmbël, ajo melodi e re që pérhajej ngadalë dhe mbështillte çdo gjë si një muzikë nate. Shikoi pullazet, që vinin njëri pas tjetrit si shkallina, tē cilat nē fund kishin atë tufë me dritëza tē arta që dukej si një konstelacion i bukur, me dritë tē pashuar.

I shkrepi nē kokë një mendim: po sikur këtë çast tē hidhej nga dritarja e tē shkonte nga një pullaz nē tjetrin duke pérshkuar rrugën që kish-te bërë Vali? Mbylli sytë. Ndjeu që u shkëput nga dyshemeja dhe kérceu nē pullazin e shtëpisë fqinjë, pastaj u hodh nē një pullaz tjetër, edhe nē një tjetër... I dukej sikur nuk ecte por fluturon-te, ajri i kulluar ja përkëdhelte fytyrën dhe palët e fustanit i rrihnin si flatra, si flamurë tē më-dhenj...

U hap dera. Lola hapi sytë. Sa kohë kishte ndenjur ashtu symbyllur? Ku ta dish...

— U mërzite? — e pyeti plaka. — Darka ësh-të gati. Sonte ma bëj kabull, moj vajzë. Bukë e zemër tē mirë.

Vajza bëri buzën nē gaz, megjithëse buzëga-zi i saj ishte pak i çuditshëm, sikur ishte refleks i një drite tē brendshme dhe nuk i përgjegjej fjal-lëve tē plakës.

Para se tē dilte nga dhoma, Lola ktheu kockën. Pa perden që e rrihte era duke e fryrë si vel.

Pastaj sytë i rrëshqitën mbi faqen e murit dhe shikoi mandolinën. Prapë dëgjoi ata tinguj dhe dhoma u mbush me muzikë, me atë muzikë të ëmbël nate...

Nisën të zbresin shkallët. Plaka para, ajo prapa. Zhurmat e shkallinave të drunjta kësaj here nuk iu dukën të huaja e të largëta... Madje asaj iu duk sikur i kishte dëgjuar dhjetëra herë dhe i kuptonte.

Kur u ulën të hanë bukë në dhomën e zjarrtit, plaka i tha:

— Ke uri, moj bijë?

— Po, nënë.

U shikuau në sy. Vështrimi i plakës ishte i kthjellët, i thellë, i menduar. Vali kishte patur pikërisht një vështrim të tillë të kthjellët, të menduar, plot shkëndija mirësie e zgjuarësie. Këtë radhë fjalët «nënë» e «bijë» dolën nga gojët e tyre krejt në mënyrë të natyrshme dhe u shqiptuan me një ton të ndryshëm nga ai që i përdorin zakonisht plakat e të rejat, kur ja thonë njëra-tjetrës ato fjalë. Duke interpretuar rolin e vajzës së saj, duke jetuar me ngjarjet dhe luftën që ajo kishte bërë, Lola e ndjente veten shumë pranë asaj plake të mirë; po ashtu e ndjente edhe ajo grua e motshme atë vajzë të re, të cilën para disa orësh nuk e njihte fare dhe tanë i ishte bërë aq e dashur.

Hëngren ngadalë, duke biseduar për gjëra të ndryshme. Për Lolën ajo ishte darka më e bukur, më tërheqëse, më e çuditshme e jetës së saj. Ajo natë do të linte mbresa të pashlyeshme.

Plaka hante pa u ngutur, duke i lëvizur shumë nofullat, ndërsa trupin e mbante drejt. Lola

vuri re se flokët e saja të krehura e të mbledhura me kujdes kishin një vezullim të butë argjendi, që i kujtuan flokët e nënës së saj.

— Ha, ha, mos ki turp! — e nxiste plaka pareshtrur, kur e shihte se vajza harronte vështrimin mbi pjatë dhe diç mendonte.

U ngritën nga tryeza e vogël dhe shkuan e u mbështetën në dy anët e vatrës mbi disa jastë-kë të mëdhenj.

— Ta ndez zjarrin, moj bijë?

— Jo, nënë, nuk kam të ftohët.

Plaka vuri buzën në gaz dhe tha:

— Vali mërdhihte shumë. Rrinte gjithmonë e struktur pranë vatrës dhe unë i thoja me shaka: «mace e hirit».

Ato fjalë i tha aq thjeshtë, sikur po fliste për një njeri që kishte shkuar para pak çastesh në dhomën tjetër.

Pastaj ajo nisi të tregojë për të bijën, për familjen e tyre, për burrin, për qytetin, për ditët e luftës. Fliste ngadalë, me zë të qetë dhe kujtimet e saj ishin të sakta, të kthjellta. Ajo i riprodhonte me atë forcë të veçantë që kanë plakatona kur tregojnë.

Lola e dégjonte e rrëmbyer. Nganjëherë i dukej sikur dremiste, mbyllte sytë dhe atëherë fjalët e plakës nuk ishin më tinguj por ktheheshin në figura të gjalla, bëheshin ngjyra, ambjente të ndryshme, rrugë, ngjarje. Ajo shikonte Valin duke shkuar në shkollë, duke marrë pjesë në mbledhje ilegale, duke shpërndarë komunikata në radhët e para të demostruesve, duke shkuar për të takuar partizanët në rrethet e qytetit. Për çudi, nganjëherë ftyra e heroinës ngatërrohej, mjegu-

Ilohej disa çaste dhe ajo shikonte veten e saj duke kryer ndonjë nga ato veprime. Kjo shkrirje me Valin e bënte t'i rrihte zemra dhe të ndjente se tani roli i saj po merrte fytërë, po përcaktohej, dhe në ditët e ardhshme ajo do të luante më e sigurtë, më bindëse, më me vërtetësi, sepse tani e njihte më mirë Valin, të ëmën, dhomën e saj, fustanet e thjeshta të varura në mur, dritaren me perden që e lëvizte era, mandolinën e saj, që e mbushte dhomën me ata tinguj të ëmbël, si muzikë nate.

Nëna prapë tregonte dhe Lola nuk e kuptionte a ishte zgjuar apo në ëndërr, a ishte aty apo ecte bashkë me Valin nëpër rrugët e atij qyteti të çuditshëm, shkonte me të në mbledhje e demonstrata dhe ndiqte së afërmi vrapimin e heroinës nëpër çatitë-shkallare, që e çonin drejt atij konstelacioni të bukur me dritë të pashuar.

DO TË FLAS EDHE UNE...

Tungjatjeta, Kristo! Si je, Islam? Po, edhe unë për mbledhje kam ardhur. Tashti duhet të filloj, apo jo? Ora është pesë pa pesë. Ashtu është, Kristo, do të jetë mbledhje e fortë. Si the, Islam? A do të flas edhe unë? Nuk e di... nejse, shohim e bëjmë. Ja, nuk është e vërtetë, unë nuk trembem. Ti mund të thuash çfarë mund të duash, Islam, por heshtja ime nuk është frikë. Nuk jam mësuar t'i ngatérroj qetë me të tjerët. Kjo është tërë puna. E di, Xhevdeti nuk kishte të drejtë dhe më ka mbetur disa herë në qafë, por... nejse, shohim e bëjmë. Jo, Kristo, nuk u preka por Islami si zakonisht ngutet, më flet rëndë. Haja, mirëupafshim! Do të shkoj të zë një vend në sallë, andej nga fundi. Islami mund të thotë se edhe këtë e bëj nga frika. Mirë, mirë edhe po ta thotë nuk nxehem se nuk kam ndër mend t'i ngatrroj qetë për një fjalë goje. Nuk po largohem, Islam. Hë, po të dëgjoj. Ashtu është, Xhevdeti më fyeni duke më thënë edhe «hajvan». Kjo është fjalë e rëndë, por prapë njerëz jemi e na hipën gjaku në kokë dhe nuk i peshojmë fjalët.

Unë nuk jam i mendjes me ty, se Xhevdeti sillet si zot i ndërmarrjes dhe është bërë «tiran i vogël». Në disa raste ai nuk ka qenë në rregull, por nuk duhen zmadhuar gjérat. Prapë ti, Islam? Si, unë paskam ndjenja të mëshirës mikrobor-gjeze? Mor Kristo, e dëgjon? Aha, edhe ti? Ahu, me ju nuk merrem vesh. Mirëupafshim!

* * *

Ka më se një orë që vazhdon mbledhja. Kam dhjetë vjet në këtë ndërmarrje dhe nuk mbaj mend një mbledhje të tillë. Shikoj presidiumin. Xhevdetit një fytyrë i shkon një tjetër i vjen. Përpinqet të mbahet i qetë, madje nganjëherë edhe buzëqesh, po duket që këtë e bën nga e keqja. Ja, e tradhëtojnë duart. Ato nuk rrijnë një çast të qeta mbi tryezën e mbuluar me cipë të kuqe. Herë i fut në xhep, herë i kryqëzon në krahëror, herë me gishta rreh tryezën dhe këto lëvizje përsëriten pareshtur. Muskujt e fytyrës nuk i lëvizin. Ato i mban të tendosur. Dreq, o punë! E shikoj dhe se si më vjen. Punëtorët gati të gjithë kritikuan sjelljet e tij, kurse mua... nuk gjej fjalë për ta thënë. Është kuadër i mirë, ka pesëmbëdhjetë vjet në parti dhe gjithmonë ka qenë në poste drejtuese. Në ndërmarrjen tonë ka gjashtë vjet që është drejtor. Mua më duket se ka drejtuar mirë. A ka të meta? Posi nuk ka, ash tu si të gjithë njerëzit. Nuk e fsheh, më duket sikur po e godasin rëndë në këtë mbledhje, që është organizuar për punimin e fjalimit të shokut Enver «Mbi kontrollin e klasës punëtore».

Afër Xhevdetit rri i deleguari. Është një nga sekretarët e komitetit të partisë. Jani e quajnë. E shikoj me sa vëmendje dëgjon dhe mban shënimë në blokun e tij me kapakë jeshilë. Pi pareshtur cigare duke e shkundur hirin në taketuken që ka përpara, i bie cigares me gishtin dëftues dhe e shkund shpesh.

Në krah të djathëtë, disa radhë para meje, janë ulur Kristua me Islamin. Ata vazhdimisht lëvizin nga vendi, kthehen anash, diçka flasin me njerëzit që kanë për krah. Sidomos Islami është më i përbajtur, dhe nuk e nxë vendi. Ai me siguri do ta marrë fjalën. Ndoshta do të zërë në gojë edhe emrin tim... Atëherë... Nejse, shohim e bëjmë.

Tani nuk po flet njeri. Fjala e furnitorit të ndërmarrjes, Kolit, u dëgjua pa vëmëndje. Ai se ç'tha duke folur si miza në qyp. Herë mbajti anën e Xhevdetit, herë tha se kolektivi ka të drejtë. Nuk ja vari njeri torbën dhe ai u ul pas pak minutash duke fshirë djersët me shami.

Nga presidiumi, Varvara, që drejton mbledhjen, është ngritur më këmbë dhe i drejtohet sallës:

— Tjetër kush e do fjalën?

Zërat u shuan në sallën e mbushur me tym duhani, pastaj rifilluan pas pak si një zukatje e pandërpërre:

— Mos flitni me njëri-tjetrin, — thotë Varvara dhe nis e kollitet, pasi nuk e duron dot tymin e duhanit. — Hë, kush e do fjalën? Hajt, shokë, mos na vononi!

Xhevdeți rri i palëvizur, me sytë mbërthyer në një pikë të pa caktuar. Vështrimi i tij është i zbruzur. Jani thith cingaren dhe e shkund pare-shtur duke e goditur me gishtin dëftues. Prapë shikoj Islamin që lëviz nga vendi dhe diçka flet me atë që ka në krah. Ai ndoshta do të ngrihet që tani dhe me siguri do zërë në gojë edhe punën time. Mos është më mirë që të ngrihem vetë e të flas? Jo, jo, ç'më duhet kjo punë. Nuk jam mësuar të ngatërroj qetë me njeri e aq më pak me drejtorin. Është e vërtetë, se atë ditë që u këput zinxhiri i motorit, që po riparoja, ai më tha: «hajvan, të pushoj nga puna» e tjera fjalë të rënda. Kur u muar vesh se zinxhiri kishte qenë i këputur që përpara, Xhevdeți nuk më tha gjë. Islami thotë se duhej të më kërkonte ndjesë. Nuk e ka keq, por... ç't'i bësh? I duhet lëshuar rrugë, se fundi i fundit ai është drejtor dhe i zien koka nga hallet. Xhevdeți edhe para tre muajsh më pat sharë, dhe në vendin tim pruri djalin e xhaxhait të tij. Pastaj... Nejse, ç't'i kujtoj këto gjëra. Të shkuara të harruara.

Këtu në mbledhje mësova edhe gjëra të tjera për të. Cudi, si foli Flamuri, ai punëtori i ri. U ngrit i pari dhe tha tërë ato fjalë të rënda kundër drejtorit. Është djalë guximtar, tha gjëra me vend por më duket sikur e teproi ca. Nuk flitet ashtu. Fundi i fundit ai është drejtor, është njeriu ynë, jo armik. Mirëpo Flamuri ja përplasi në fytyrë duke thënë se Xhevdeți ka harruar klasën e vet dhe në punë është sjellur si padron. Jo, mor vëlla, kjo gjë i kalon kufitë dhe e shpartallon njeriun. Nuk bëhet kështu kritika. Unë, të them të drejtën, prita që shoku Jani të ndërhy-

te, por ai vetëm pinte cigare mendueshëm dhe mbante shënime. As Varvara nuk tha gjë, as Mihali, sekretari i partisë. As ndonjëri nga kolektivi nuk hapi gojën. Disa pëshpëritën. Nuk e mora vesh a ishin në një mendje me Flamurin apo ishin kundër tij. Nuk e kuptova atë pëshpëritje.

Ja, tani nga radhët e para u ngrit një dorë. Kush është ai që kërkon të flasë? Nuk e shoh. Prit. Aha, qenka kovaçi i repartit të fonderisë. Po ky?

— Qetësi, shokë! E ka fjalën Veliu.

Para meje u ngrit shpina katrore e kovaçit të moshuar, njërit prej punëtorëve më të vjetër të ndërmarrjes. Kovaçi është njeri i zgjuar, i mirë dhe them që ai do t'i dalë zot Xhevdetit. Veliu flet pak rrallë, po ato që thotë zënë vend dhe duket sikur ai godet me çekiç aty ku duhet.

Në sallë u bë qetësi dhe Veliu e ngriti zërin. Fjalët e para nuk ja kuptova, kurse tani dëgjohet mirë.

«Këtu po flitet shumë për drejtorin tonë. Me të gjithë sa thanë shokët para meje jam dakord. Pse ta fshehim, kështu është. Shokut Xhevdet i ka marrë koka erë. Çfarë kujton ai se me punëtorët mund të sillet si t'i dojë qejfi? Perëndoi ajo kohë, sot nuk lë partia njeri që kapardiset si gjeли në pleh. Kështu është. Nuk flas për veten time. Ai mua nuk më ka bërë asgjë, e kurrë nuk më ka thënë ndonjë fjalë të rëndë, po kjo nuk ka rëndësi. Puna është se shoku Xhevdet ka qëndruar larg punëtorëve, nuk e ka njohur shpirtin e tyre. Ai vetëm shkon e vjen në ndërmarrje hipur mbi gazin e tij dhe rrallë kalon si hije nëpër repartet ku ka hallet e realizimit të planit. Kështu

është. Ore, po qëndrove larg punëtorëve, qofsh kush qofsh, herët a vonë do ta pësosh, se kjo tregon që të ka marrë koka erë. Drejtori ynë është bërë fodull dhe gojështhurur. Kështu është. Ai mban afër dy-tre njerëz që i shkojnë pas fillit dhe ja bëjnë qejfin. Këta janë Koli, furnitori, Adami që ai e bëri shef reparti dhe Samiu që e ka kushtëri. Këta njerëz ai i dërgonte nëpër reparte që të dëgjonin se çfarë thonin punëtorët kundër tij, që pastaj të hakmerrej. Kështu është. Për këtë t'i vijë turp e t'i kuqet faqja. Flamuri e tha bukur: «Xhevdeti ka harruar klasën e tij, është shkëputur nga punëtorët, dhe tani të japë llogari. Posi, të japë që c'ke me të. Kështu është. Unë mendoj që ai ka nevojë të vijë në mes tonë, të punojë, të jetojë me ne se kështu do të shërohet. Edhe Mihali si sekretar i partisë ka përgjegjësi, megjithëse drejtori nuk e pyeste dhe bënte si i thoshte koka. Por megjithatë Mihali ka përgjegjësi, se duhet të luftonte më shumë dhe mos të linte që punët të trasheshin deri në këtë pikë. Kështu është.»

Hajde të folur, hajde! Ky ja kaloi Flamurit. Si kështu? Deri këtu paska mbërrijtut Xhevdeti? Unë kujtoje se... nejse. Nuk ma merrte mendja se kovaçi do të godiste kaq rëndë. Mos u rrëmbye Veliu? Ai nuk e ka zakon të flasë në erë dhe t'i mbesë në qafë njeriu. Pastaj ai vetë tha se Xhevdeti nuk i kishte bërë asgjë të keqe. Atëherë? Or, po qështë kjo kështu?


Tani që u ndezën dritat, fytyra e Xhevdetit duket e bardhë dhe po ta vesh re me kujdes, sheh që ai shtrëngon nofullat dhe, megjithëse fytyra

nuk i lëviz, duart e tregojnë shqetësimin e tij. Prapë po pi cigare Jani? Më duket sikur ai nuk bën tjeter vëçse shuaj e ndiz. Deri tani nuk ka hapur gojë, vetëm shkruan e pi cigare. Ai dëgjon me vëmendje dhe e mban të përqëndruar atë fytërën e tij të hequr, të gjatë, me mollëzat e dala. Një tufë flokësh i ka rënë mbi ballin e gjerë, por ai nuk e ka ngritur kurrë lart, se me një dorë mban pendën dhe në tjetrën cigaren. Përtej Varvarës shikoj Mihalin që, siç e ka zakon, kruan herë pas here zverkun e fuqishëm dhe ngrys vetullat e trasha, duke shkruar me një copë të vogël lapsi në letrën që ka përpara.

Megjithëse Veliu heshti, prapëserapë fjalët e tij bënë jehonë. Dëgjoj se ato komentoohen nga punëtorët. Të gjithëve u kanë bërë përshtypje. Edhe mua. Po, po edhe mua, megjithëse...

Si the Arta? Si m'u dukën fjalët e Veliut? Rri e vështroj frezatoren e re me leshra të verdha që rri pranë meje dhe them me vete se mos ma bëri këtë pyetje me qëllim, për të më dhënë të kuptojo se si janë punëtorët e vërtetë dhe si flasin ata. Po, po, më duket se ajo ma bëri me qëllim atë pyetje. Këtë e kuptojo jo vetëm nga mënyra si ma bëri, por edhe nga ajo shkëndizë që u ndez menjëherë në sytë e saj të mëdhenj që vështrojnë ngultas. E shikoj që rri e pret përgjegjen time. Ajo pandeh se unë do t'i jap një përgjegje të përgjithshme ose ndoshta... Mirë, le të pandehë ashtu. Unë do t'ja them copë mendimin tim:

— Fjalët e Veliut më pëlqyen shumë. — Foli ashpër, por drejt. — Ai është njeri që godet në shënje. Megjithëse...



C'dreqin më doli nga goja kjo fjala e fundit? Nuk desha ta them por... Ajo duket sikur krijon një farë rezerve për atë që thashë më lart. Vura re se Arta më shikoi me interesim dhe e përsërithi fjalën time të fundit. Por unë ja preva shkurt: Jo, nuk desha të shtoj asgjë.

Prapë po ngrihet më këmbë Varvara. Pyet kush do të flasë dhe kollitet nga tymi i cigaretteve. Xhevdeti shikon përparrë pa lëvizur. Jani pi cigare, kurse Mihali shkruan me atë copën e vogël të lapsit dhe herë pas here kruan zver-kun.

Nuk po e merr fjalën asnjeri. Punëtorët janë të menduar. Sheh Islamin që bisedon me Kriston, lëviz duart dhe nuk e zë vendi. Ai do të flasë me siguri. Habitem pse nuk është ngritur deri tani. Islami do të më zërë në gojë edhe mua. Atëherë...

Varvara flet diçka me Mihalin e me një tjetër, pastaj i drejtohet sallës:

— Bëjmë dhjetë minuta pushim.

Kërcasin stolat dhe njerëzit ngrihen dhe dalin nga dera e sallës duke biseduar me gjallëri. Unë nuk lëviz. Nuk kam ku të shkoj. Po rri më mirë këtu të mendohem për këto që ngjasin këtu, në këtë mbledhje të kolektivit tonë.

Salla pothuajse u zbrazi. Në presidium mbeti vetëm Xhevdeti. Tani, që gati të gjithë dolën, e shoh më mirë. Ja, jemi përballë njëri-tjetrit, ai në presidium, unë në sallë. Ai ngre kokën dhe vështron nga unë. Shikimet tona kryqëzohen. Më duket i bardhë në fytyrë, jo, i zbetë, i vogël, i pafuqishëm. Sigurisht më vjen keq për të se ësh-

të njeriu ynë po si të them, keqardhja ime ndryshon nga herët e tjera. Është një ndjenjë e re, e paprovuar deri tani. Nuk kam më asnë dyshim: Xhevdeti ka gabuar rëndë, më shumë, ai është fajtor. Këtë gjë tani e kuptoj mirë. Jo, nuk është puna se i zien koka nga hallet dhe është gjak-nxehtë, po ai ka gabuar se i është rritur mendja dhe e mbante veten mbi të gjithë. Duke u fryrë si balonë e duke u ngritur lart ai u shkëput nga toka, u bë si pemë pa rrënjetë, se rrënjetë e tij jemi pikërisht ne, punëtorët.

E shikoj që ai ktheu kokën nga dera. Vështroj profilin e tij, buzët e shtrënguara, flokët e shpupurisura që i ngrihen drizë. Mbi të bie nga tavani drita, dhe në sfondin e kuq të tabelës së madhe të emulacionit profili i tij spikat shkoqur. Më bëjnë përshtypje buzët e shtrënguara fort. Më duket sikur cepat e tyre janë kthyer poshtë, ballin e ka të rrudhur. Faqen që ka kthyer nga unë ja pret një rrudhë e thellë, që i zbret deri tek mjekra. E ka patur edhe përpara atë rrudhë.

Hë, Arta, u ktheve? Unë qëndrova këtu. Nuk kisha ç'të bëja jashtë. Si the? Ç'të bëja në klub, ti e di që unë nuk e pi kafenë. Po, mbledhja po shkon shumë mirë. Punëtorët të gjithë folën si duhet. Jo, jo nuk them më «megjithëse». Pak përpara e përdora atë fjalë ashtu kot. Nuk desha të nënkuptoj gjë e të shfaq ndonjë rezervë. Si? Nuk e di, ndoshta do të flas, nejse shohim e bëjmë. E ke gabim, nuk është puna se unë gjithmonë kështu përgjegjëm, por duhet të mendohem. Mirë, mirë, e di se edhe me mua Xhevdeti është sjellur keq. E kuptoj se duhet të them fjalën time si punëtor. Jo, Arta, nuk kam frikë po s'dua

të ngatërroj qetë... Kot e thashë këtë fjalë. Jo, jo asgjë. Nuk u preka, për nder, ja. Ku po shkon? Aha, të thirri Zana.

Ajo u largua. Shkuan pranë drifores dhe se ç'bisedonin njëra me tjetrën. Arta tund kokën dhe qesh. E shikoj me vëmendje. Është vajzë e mirë dhe guximtare. Ka patur një fatkeqësi në jetën e saj. Është ndarë nga i shoqi, që ishte aventure e pijanec. Ai punonte si shitës dhe doli deficít. Pasi u vërtetua se kishte vjedhur dhe e dënuan, Arta e ndau dhe tani jeton vetëm me vajzën e saj dy vjeçë. Është e fortë, kurë nuk e jep veten dhe vajzën e rrit me dashuri të mëdhe. Nuk kam dëgjuar njeri të thotë një fjalë të keqe për të. Çudi, edhe ajo më tha se duhet të flas. Ç'kanë me mua, xhanëm? Pa mirë, të gjithë e kanë gabim dhe vetëm unë paskam të drejtë.

Ja, po shikoj prapë Xhevdetin. Ai ka kthyer kokën nga unë dhe vështrohemë sy në sy. Shikimi i tij më duket ndryshe nga herët e tjera. Edhe supet i ka të rëna, të kërrusura nga një peshë e rëndë.

Hë, shoku drejtor, të kujtohet si më the atë ditë? Mendohu, mendohu mirë. Apo nuk të kujtohet se për ty ajo sjellje ishte e zakonshme dhe nuk të bënte asnë përshtypje? Kurse mua më vrap, po, më vrap por heshta. Po ashtu e kyça gojën edhe dy-tri herë të tjera. Si thua, bëra mi-rë? Tani, po pikërisht tani mund të them se nuk bëra hiç mirë. Kështu është, siç thotë Veliu.

Më duket se diçka po ngjet brenda meje. E ndjej se grushti i fuqishëm i shokëve të mi nuk po shkund vetëm Xhevdetin por edhe mua.

Gjatë kohës që punoj këtu, thua jse gjithmo-

në kam qëndruar si i mënjanuar, i ndarë nga shokët. Shikoja punët e mia dhe pikë. Vija në punë dhe nga puna në shtëpi e anasjelltas. Nuk mbaj mend të kem folur nëpër mbledhje dhe të kem kundërshtuar, edhe atëhere kur duhej, ndonjërin nga drejtuesit. Kur hyra në fabrikë, kisha dy vjet që kisha ardhur nga fshati dhe nuk isha mësuar me qytetin e me njerëzit e këtushëm. Pse ta fsheh, më dukej vetja si i huaj në mes të tyre dhe nuk doja të përzihesha me njeri ose, duke përdorur fjalët që thotë im atë e që unë e përsëris shpesh, «nuk doja të ngatërroj qetë me njeri». Madje ato fjalë i përdora edhe me Kriston e Islamin dhe tani në fund, pa dashje, ja thashë edhe Artës. Për Artën them pa dashje se me të vërtetë nuk desha t'i them, sepse tani... Nuk e di se ç'kam. Dreq o punë, sa gjë e ngatërruar kjo puna e njeriut. Ndoshta nuk është e ngatërruar, po ashtu më duket mua. Flas me vreten time. Ç'kam, pse jam kaq i shqetësuar? Nuk po më nxe vendi as mua. E ndjej se jam ngashëryer. Ç'do të thotë kjo?

Pushimi mbaroi dhe salla po nis përsëri të mbushet. Njerëzit zënë vend duke biseduar me njëri-tjetrin. Jani u ul në tryezën e presidiumit dhe vuri përpara blokun e shënimave. Tani nxori paketën e cigareve dhe ja zgjat Xhevdetit. Madje edhe po ja ndez. Fytyra e sekretarit është e rreptë e balli i tij plot rrudha.

Në këtë çast Varvara ngrihet më këmbë. Pret sa të hyjnë edhe disa punëtorë pastaj e pyet njërin:

- A ka të tjerë jashtë?
- Jo.

— Mbylleni derën! — Kthehet nga salla dhe thotë:

— Atëherë, shokë, vazhdojmë mbledhjen. Cili e do fjalën?

E ndjej që shqetësimi im sa vjen e shtohet, si ajo vala kur i afrohet bregut. Islami kthen kokën nga unë. Më shikon ngultas. Po, Islam, e kuptoj se ç'don të më thuash.

Si the, Arta? A do të ketë diskutime të tjera? Them se do të ketë pa tjetër. Pse e vë buzën në gaz? Të kuptoj, po, edhe ty të kuptoj.

Varvara përsëriti pyetjen.

Vala vjen duke u rritur dhe tani do të përplaset në breg me gjëmim. Varvara, shiko kënëdej nga fundi, shiko e mos u habit! Po, jam unë, Bashkimi, që kam ngritur dorën dhe dua të flas.

Më pe? Hë, çfarë tha? Mos u habit. Edhe Jani ngriti kokën dhe po më shikon, ndërsa shkund hirin duke e goditur cigaren me gishtin dëftues.

Arta diçka po flet me njeriun që ka pranë. Ndoshët flasin përmua, por unë nuk i dëgjoj se ç'thonë. Rri me dorën e ngritur lart.

Varvara e tha emrin tim dhe një pjesë e punëtorëve i kthyen kokat e shikojnë nga unë.

Tani që po eci në mes të vargut të stolave, duart e mia takojnë trupat e shokëve të punës. Sytë e mi takohen me sytë e tyre. Po, Islam, do të flas.

Ja, mbërrijta në krye të sallës, në një anë të presidiumit. Të tjerët dolën nga vendi, kurse unë, pa e ditur përsë, u ngrita dhe tani jam këtu. Drita më bie në fytyrë. Përballë kam presidiumin. Aty është Xhevdeti. Në krah kam shokët.

Salla po hesht. Duhet të filloj. Ata presin.

— Shokë, do të flas edhe unë. Ja, tani po ja nis...

NË DY ANË TË TRASESE

Malësori kishte më se një orë që sillej në-për vendet ku punonin vullnetarët e atij sektori. Ekte me hapa të mëdha, vende-vende kapërcente trasenë, ndalej, pyeste ndonjërin, vijonte rrugën. Nganjëherë qëndronte dhe shihte i habitur të rintjtë që punonin me vrull. Atij i bëri përshtypje se në disa vende ata punonin të përzier, djem e vajza bashkë. Madje ai vuri re një vajzë që shtynte vagonin bashkë me një djalë flokëverdhë, që diç bisedonin duke qeshur.

Eci tutje dhe prapë pyeti për brigadën ku bënte pjesë Marta. Një vajzë me trup të imtë e sy të shkëlqyer, që ngulte në tokë disa kunja, i tha:

— Janë atje — dhe zgjati dorën drejt një kodre.

Kur shkoi atje, ai vuri re se shumica e tyre bartnin dhë me karroca dore. I shikoi. Nuk njo-hu asnjeri. Ai nuk e njihte as Martën, pasi ishin fejuar që në vogëli dhe kurrë nuk ishin takuar.

Nisi të mendojë: «Të pyes tani për të nuk bën. Më mirë po pres sa të mbarojnë punën».

U ul në një cep të rrugës automobilistike që kalonte aty pranë. Ndjeu se ishte i lodhur. Kish-te uri. U kredh në mendime. Ishte i shqetësuar. Si do të shkonte takimi me Martën? C'ishte ajo letër që ajo i kishte dërguar para një javë: «Eja të takohemi. Dua të rrijmë e të bisedojmë një herë. Nuk mund të martohem me një njeri që s'e njoh».

Në rrugë kaloi një kamion i ngarkuar me drurë. Ai pa shoferin duke kafshuar një mollë. Pas kamionit në rrugë u dukën një grumbull vull-netarësh. Tri vajza e katër djem. Të gjithë të veshur me pantallona. Të gjithë me shalla të lidhur pas qafës. Kishin me vete kazma e lopata. Vajzat i kishin flokët të prera. A thua edhe Marta ashtu ishte bërë? Grupi kaloi para tij duke biseduar me gjallëri. Në vesh i erdhën vetëm disa fjalë të shkëputura.

— Nesër do të shkojmë në Vlorë...

— Në mbrëmjen e vallëzimit kishte më shumë vajza...

— E ke gabim, flamuri i takonte kompanisë sonë...

— Figura e Katrinës më kujton Dilën që fle pranë meje...

Malësori e ndoqi me sy, pastaj u kthyte e shikoi kodrën.

Ja, në mes të atyre të rinjve ishte Marta. Ku punonte? Cila prej atyre vajzave ishte e fejuara e tij? E si ishte ajo, e shkurtër apo e gjatë? E bukur apo... E ashpër apo gojëmbël?

Në rrugë kaloi me shpejtësi të madhe një-veturë. Rrotat lëshuan një fishkëllimë të zgjatur duke u fërkuar në asfaltin e zi.

* * *

Megjithëse e priste, Marta u habit kur i thanë se e kërkonte në hyrje të kampit. Madje edhe u trondit pak. Shikoi përreth. Lena e Tonia ja kishin ngulur sytë. Ajo e kuptoi vështrimin e tyre. Ato dinin gjithshka. U ngrit nga shtrati.

— Mos është ai? — pyeti Tonia.
— Kushedi... — tha Marta duke u përpjekur të dukej e qetë.
— Do të dalësh? — pyeti Lena.
— Posi.

Dy vajzat u matën t'i thonë diçka por hesh-tën. Marta zbriti nga shtrati dhe kaloi në mes të shtretërve të fjetores. Iu duk sikur të gjitha e shikonin. Vullnetaret ishin të zëna me punë. Njëra qepte, tjetra këndonte nën zë me duart lidhur pas zverkut, dy të tjera diç bisedonin me zë të ulët, kurse një e pestë po shkruante një letër mbi valixhen prej dërrase.

Kur doli te dera, qëndroi një çast dhe hodhi sytë tek hyrja e kampit. Aty ishin katër njerëz. Ajo takohej për herë të parë me Markun. Po sikur te hyrja e kampit të gjithë të janë të rinj, atëherë si do ta njihte të fejuarin? Ky mendim e shqetësoi. «Unë do të shkoj aty dhe do të rrij», mendoi me vete, «ai që është Marku le të afrohet dhe të më flasë.»

Duke përshkuar oborrin që vlonte nga të rinjtë dhe ishte i mbushur me thirrjet gazmore të atyre që luanin volejboll, Marta nuk shikoi fare nga hyrja. Papritmas u ndodh përpëra një djali trupgjatë, me flokë të paqethura. Ngriti kokën. Pa dy sy të mëdhenj, gati të bardhë, që e shikonin ngultas.

— Ti je Marta?

Ajo pohoi me kokë dhe i uli sytë përdhe.

— Si je? — foli djali pas një heshtje që asaj
iu duk e gjatë. Zëri i tij ishte i thellë po prapë
iu duk i ftotë dhe sikur vinte nga larg.

— Mirë.

— A më njeh?

Ajo e shikoi përsëri. Sytë e djalit e shikonin
me vëmendje. Ajo vuri re se ai i hapte dhe i
mbyllte shpesh qepallat e gjata, që lëshonin një
hije të lehtë në fytyrën e tij të zgjatur.

— Jo, — u përgjegj ajo pas një heshtje. Pa
e kuptuar u skuq. Uli sytë përdhe dhe shikoi kë-
pucët e mëdha të mbuluara me pluhur të malë-
sorit.

— Jam Marku, — tha ai pas pak. Zëri i tij
u bë më i ëmbël. — Erdha të të takoj. Ti më
shkrueje një letër që të vijsha, apo jo?

— Po.

Prapë heshtën. Në oborr dëgjoheshin thirr-
jet e të rinxve, që nxitnin shoku-shokun ose grin-
deshin me gjyqtarin e lojës.

Martës i vinte inat që nuk mund të fliste
lirisht me atë djalë. Ajo vetë e kishte thirrur. Ish-
te menduar shumë, disa net e kishte marrë gju-
mi në orët e vona, derisa më në fund kishte ven-
dosur t'i bënte atë letër të fejuarit të panjohur.
Kurse tani që e kishte përpara, i ishte kycur goja
sikur ta kishte zënë njeri përfyti. Bëri një për-
pjekje përf t'u çliruar nga ajo dorë e padukshme
dhe tha:

— Kur erdhe?

— Ka disa orë. Jam nisur qysh die. Nuk ësh-
të kollaj të vish nga malësia deri këtu. M'u desh
të ndërrroj tri maqina.

Vajza ngriti kokën dhe e shikoi disa çaste në fytyrë. Vuri re se, kur fliste, malësorit i dridhej lehtë buza e poshtme që ishte e trashë dhe si e përveshur, kurse buza e sipërme thuajse nuk i lëvizte fare. Pastaj ajo shikoi krahët e tij të gjatë, supet e rëna dhe duart me gishta të shkurtër që lëviznin pareshtur dhe herë mbylleshin grusht, herë hapeshin duke u mbështetur në pantallonat e tij prej kadifeje bojëmjalti.

— Mbasdite keni pushim apo jo? — pyeti ai...
— Po.

Prapë i erdhi inat që u përgjegj ashtu shkurt e thatë dhe nuk i tregoi se vërtet nuk punonin, por në orët e lira merreshin me aktivitete të ndryshme, mësonin të qepnin, të gatuanin, merrnin pjesë në grupet artistike ose shihnin shfaqje dhe filma.

Marta përpiquej pareshtur të çlirohej nga ajo dorë e padukshme që e shtrëngonte. E dinte se më në fund do të arrinte ta flakte tej dhe atëherë do të fliste lirisht, do ta pyeste, të mësonte jetën e tij e të familjes, mendimet që kishte ai dhe pastaj të vendoste a shkonin njëri me tjetrin dhe të lidhnin jetën.

Atë çast një kamionçinë u ndal tek hyrja, i ra disa herë burisë. Ata u shtynë në një cep. Kamionçina kapërceu urën prej dërrase dhe u fut në oborr e shkoi u ndal tek dyqanet.

Marta e ndoqi me sy. Pa se nga kabina zbriti një grua e veshur me një përparëse të bardhë, që hyri në dyqanin e frutave.

— A shëtisim pak? — dëgjoi nga prapa zërin e Markut. Iu duk sikur ndjeu një farë mërzitje në fjalët e tij.

Ajo nuk u përgjegj. E kuptoi se propozimi i tij ishte me vend. Ndoshta duke ecur, larg kampit, mund të bisedonin më lirisht. Duke ecur nuk do ta kishte më përballë Markun, nuk do të ndjen te mbi vete shikimin e tij hetues.

Pa iu përgjegjur nisi të ecë. Këmbët e çuan nga vendi ku punonin, pranë trasesë së shtruar me shina. Dielli po perëndonte dhe hijet e muzgut shtriheshin të shpejta mbi qytetin e vogël të vullnetarëve, mbi rrugën e asfaltuar, mbi faqet e kodrave.

Teksa ecnin, thirrjet e volejbollistëve erdhën duke u shuar dhe kampi mbeti prapa tyre. Marta e ndjeu se lëvizja i bëri mirë dhe i shmpiu jo vetëm gjymtyrët por sikur e bëri më të lehtë, më të gjallë, madje më të guximshme. Ende nuk kishte hapur gojë, por e kuptoi se tani biseda e tyre do të merrte tjetër rrugë.

Marta hidhte sytë dhe shikonte vendin ku punonte. E njihte atë vend me pëllëmbë. Nganjëherë kthente kokën dhe e vështronte Markun, që e cte ngadalë e pak si i kërrusur. Ai ishte i gjatë dhe shpina i përkulej saqë dukej si një kurrizo. Këmbët i hapte shumë dhe këpucët i lëshonin një krisëm të thatë në tokën e fortësuar nga thatësira.

— A je e kënaqur këtu? — pyeti ai papan-dehur. Martës nuk i pëlqeu toni i ftohtë dhe pak i ashpër me të cilin i foli ai.

— Shumë, — u përgjegj vajza shkurt. Por nganjëherë, vijoi, — jemi njoftë me shumë shqeqe dhe kemi qenë në Tiranë, në Durrës, në Berat.

U gëzua fort që për herë të parë foli gjatë dhe e shprehu mendimin e saj lirisht. Mori fry-

më thellë. «Tashti që nisa të flas, duhet të vijoj më me ngulm», mendoi. Dora e padukshme që i shtrëngonte fytin pësoi tronditjen e parë. Ajo nuk ishte më e fortë si tek hyrja e kampit.

Marku nuk u përgjegj por sikur përtypi disa fjalë nëpër dhëmbë. Ajo e kuptoi se atij nuk i pëlqyen ato fjalë. Kushedi ç'mendime kishte në kokë ky djalë i panjohur, që e mbante veten i fejuari i saj... Që në fjalët e para, atje në hyrje të kampit, asaj i ishte dukur se malësori i kish-te folur me një ton prej kapadaiu që mundohej ta fshihte dhe ishte sjellë si sillet njeriu me një plaçkë, të cilën e ka blerë dhe e di që herët a vonë do të bëhet pa tjetër e tij.

— Po ti pse nuk ke ardhur vullnetar në hekurudhë? — e pyeti ajo pas pak. Vuri re se pa e ditur foli me zë të plotë dhe, si i tha ato fjalë, qëndroi dhe e shikoi në kokërr të syrit.

Edhe Marku qëndroi dhe e shikoi i habitur.

— Unë? — tha ai me inat por përnjëherësh vuri buzën në gaz dhe shtoi: — e po gjithë malësia nuk mund të vinte në hekurudhë. Nuk ka vend pér të gjithë.

— A kërkove ti?

— Jo. Pse?

— Kot. Desha ta di.

Pas këtyre fjalëve vazhduan të ecin. Papritisës në mes tyre sikur u krijuat një zonë me hije, sikur u ngrit një gardh i lartë. Tani ata po ecnin në dy brigjet e kundërta të një lumi me ujëra të ftohta.

Kapërcyen një hedek dhe dolën në rrugën automobilistike. Disa kamiona të ngarkuar me

arka konservash kaluan me shpejtësi. Marta le-xoi targën: «Br». Iu kujtua vizita që kishin bërë para një javë në kombinatin e tekstileve në Berat dhe i erdhën ndër mend punëtorët që lëviznin në mes të vargut të pafund të maqinave.

— Pse nuk po flet? — tha Marku. Zëri i tij ishte bërë më i ftohtë dhe gati i ashpër.

— Do të flas.

— Hajt! Po pres.

— Pse bërtet?

— Unë? Nuk po bërtas. Kështu e kam zërin.

Kaloi një veturë e verdhë. Nga brenda një grua e thinjur ktheu kokën dhe i shikoi. Martës iu duk se ajo vuri buzën në gaz.

— Çfarë pune bën në fshatin tënd? — e pyeti ajo. Zëri i saj ishte i qetë dhe toni i sigurtë.

— Punë bujqësore, çfarë pune tjetër kujtovë ti?

— A e ke mbaruar shkollën tetëvjeçare?

Ai u mendua një çast.

— Jo. Kam bërë vetëm katër klasë.

Atë çast dëgjuan një uturimë motori dhe një buri të ngjirur që ushtoi pas tyre. U tërhoqën në zgrip të rrugës. Pranë tyre kaloi një kamion i ngarkuar me tuba të gjatë. Një valë tyimi e skapamentos i mbuloi dy të rintjtë.

Dolën nga rruga, ngjiten të përpjetën dhe u gjendën pranë trasesë. Kishte nisur të errej, dhe në qielin e pafund po shuheshin shkëlqimet e ditës.

— Dëgjo, — tha Marku dhe qëndroi në vend. Marta vijoi të ecte dhe qëndroi sipër trasesë, pranë një ure të vogël të porsambuar. Marku merrte frymë me vështirësi, pasi e kishin ngjitur

me një frymë të përpjetën. Nga mënyra si e tha ai atë fjalë, ajo kuptoi se po bëhej gati të thoshte diçka të rëndësishme dhe biseda do të bëhej e ashpër. Le të bëhej. Marta tanë ishte e qetë dhe e ndjente shumë pak dorën rrëth qafës.

— Dëgjo, — përsëriti edhe një herë ai, — nuk po më pëlqen pritja jote. As fjalët që më ke thanë deri tash.

Ajo desh t'i përgjegjej. Pastaj ndërroi mendim, që ta dëgjonte deri në fund.

— Unë kam bërë gjithë këtë rrugë për të ardhur deri këtu. Në fillim nuk deshta të vij. Edhe njerëzit e shtëpisë nuk donin. Ku është parë të shkojë djali sipas fjalës së vajzës, që të njihen. Megjithatë e bëra zemrën gur dhe erdha. Por ti duhet të më pritshe ndryshe. Ç'janë këto pyetje. Ku jemi, në gjyq?

— Pse thua në gjyq? — iu përgjegj Marta.
— Ne na kanë fejuar që në vogëli. Nuk njiheshim. Unë nuk mund të martohem me një të panjohur. Nuk mund të lidh jetën me ty pa u bindur a shkojmë me njëri-tjetrin.

— T'u paskan hapur sytë këtu në hekurudhë! — tha Marku me një buzëqeshje shpotitëse.

— Po, m'u kanë hapur, — u përgjegj ajo me inat.

— Ngadalë, moj vajzë, mos merr si flakë kashste. Po, po, e shoh se ta paskan turbulluar menjë konferenca. Por mos harro se, sido që të thuash ti, burri është burrë, dhe gruaja nuk është tjetër veçse hija e tij.

— Kështu thua ti?

— Kështu është.

Gati njëkohësisht të dy nisën të ecnin gjatë

trasesë në të dy anët e shinave, larg njëri-tjetrit. Në rrugë kalonin pareshtur maqina, me dritat e tyre çanin me lehtësi errësirën. Edhe në qytetin e vogël të vullnetarëve ishin ndezur dritat. Marta e harroi për një çast djaloshin që ecte në anën tjetër të trasesë dhe nisi të mendojë se ç'po bënin tani shoqet atje në kamp.

— Kot e ke që bëhesh merak për mua, — dëgjoi zemrën e markut, që iu duk sikur vinte nga larg. Hoqi shikimin nga qyteti i vogël i ndriçuar dhe mbajti vesh. — Ne do të shkojmë mirë bashkë. Unë në fund të fundit po e harroj bisedën që kemi bërë deri tash.

Ajo vuri re se zéri i tij u bë i lehtë dhe më i përzëmërt. Por ajo e dinte, ajo e ndjeu menjëherë se ajo mënyrë ishte e shtirur dhe nuk i besohej.

— Pse nuk flet? — tha ai pas pak dhe, duke pandehur se ajo po mendonte e penduar për fjalet dhe sjelljen e mëparshme, vijoi. — Po, besa, do të shkojmë mirë. Po nuk e dite, po të them se ne jemi shtëpi e parë në krahinën tonë. Do të jesh mirë tek ne, do të të mbajmë në pëllëmbë të dorës. As nuk do kesh nevojë të punosh.

— Domethënë do të qëndroj e myllur benda katër mureve? — tha Marta, duke përbajtur me zor inatin që i vlonë përbrenda.

— Po, nuk do të kesh nevojë të punosh. Ç'të duhet ty puna? Më mirë larg njerëzve. Gruaja ka lindur të bëjë punët e shtëpisë, të rrisë fëmi-jët dhe t'i shërbejë burrit.

Ajo desh të flasë, të kundërshtojë po s'e hapi gojën. Donte që ai të fliste lirisht e t'i thonte mendimet që kishte.

Pas pak malësori vijoi:



— Edhe një gjë tjetër po të them. Mbasit të martohemi, nuk dua të kesh më punë me rininë, me hekurudha ose me gjëra të tjera. Duhet të heqesh dorë një herë e mirë. Do të jesh vetëm grueja ime, do të bësh si do të them unë.

Përnjëherësh Marku mbeti larg saj në anën tjetër dhe dukej si një pikë e zezë. Marta ishte e tronditur nga mendimi që i shkrepit në kokë se çfarë do të ndodhte me jetën e saj sikur mos të ishte bindur që t'i shkruante të fejuarit dhe të njihej me të.

Plakosi një heshtje e rëndë. Marta ishte ende e tronditur, megjithëse vala e zemërimit sa vinte qetësohej dhe ajo merrte frymë lirisht. Shikoi Markun që rrinte në anën tjetër të trasesë i mbështjellë nga hijet. Pastaj hodhi sytë dhe shikoi shinat që shtriheshin përpara, të gjata, të ndërtuara të pasundta.

— Nuk kemi çfarë të flasim më, — nisi të thotë me zë të qetë por të vendosur dhe duke i shkoqitur mirë fjalët. — Ne nuk na lidh asgjë. Jemi të huaj për njëri-tjetrin. Unë nuk mund të bashkohem me një njeri si ti, prandaj e prish fejesën.

Dhe u nis përpara nëpër trase, gati me vrap. Era ja rrihte fytyrën. Në rrugë kaloi një autobus me drita të ndezura. Prej tij shpërndahej shin tingujt e gëzuar të një fisarmonike. Ajo vazhdoi të ecte mbi shinat e gjata e të ndritura me zemër të lehtë e të fuqishme dhe gjithnjë e më shumë afroheshin pranë saj dritat dhe zhurmët e dashura të qytetit të vullnetarëve.

Kurse Marku mbeti aty në një cep të trasësë si një vagon i vjetër, i harruar.

NJË ZË NGA RRUGICA

J o, Neta, nuk kam asgjë. Jam pak e ftohur prandaj nuk këndova mirë. Pse qesh? Nuk e beson? Ti do të më ngacmosh. Po ta përsëris, jam e ftohur. Mbrëmë, kur dolëm nga provat, më zuri shiu. Isha pa çadër dhe u bëra qull. Sa ësh-të ora? Shtatë e gjysmë? Siç duket edhe sonte do të vonohemi. Kemi ardhur që në katër dhe ende nuk kemi bërë një provë të plotë të tërë programit. Disa erdhën vonë, pastaj Andoni me Lekën zunë të qeshin ndërsa luanin një skeç dhe kështu u ndërprenë provat. Erdhi kryetari i komitetit profesional dhe na bëri një orë mbledhje. Edhe tani provat nuk shkojnë mirë. Disa aktorë nuk i kanë mësuar tekstet, orkestra nuk i ka orkestruar tërë këngët, kurse dekorë ende nuk ka përfunduar. Regjizori bëhet nevrik dhe thërret duke lëvizur pareshtur nga vendi. Nuk ka faj. Pas pesë ditësh fillon festivali dhe grupi ynë është prapa. Fabrika jonë është paraqitur çdo vit mirë, madje disa herë ka marrë edhe çmime të para, prandaj duhet që edhe tani të bëjmë një shfaqje të bukur. Mirëpo siç duken punët... Por

prapë nuk i dihet, se arti ka të papritura. Kam disa vite që marr pjesë në grupin artistik dhe kam vënë re se përgjithësisht nëpër prova kurërë nuk kënaqesh. Por vjen dita e premierës, të gjithë mobilizohen, publiku të jep zemër dhe çdo gjë shkon si më mirë. Kur mbylljet perdja, harrohet lodhja, shqetësimi, grindjet dhe të gjithë përqafohen dhe urojnë njëri-tjetrin. Punë e rëndë por e bukur kjo e artit. Unë e pëlqej shumë dhe marr pjesë me shumë dëshirë në grupin e ndërmarrjes. Mirëpo tani jam fejuar dhe kam vënë re se Hilmiut, të fejuarit tim, kjo gjë nuk i pëlqen. Në fillim ma tha me mënyra të tërthorta, por kohët e fundit ma ka thënë copë. Jetimi grindur disa herë për këtë gjë. Sidomos mbrëmë.

Këto gjëra rrrij e mendoj tani, e ulur në një stol, këtu në prapaskenë. Në këtë çast bën prova grupi i valleve. Drejtuesja e tyre, një vajzë që dikur ka qënë në ansamblin e këngëve e valleve të Tiranës por që tani është martuar me një marinare dhe banon në qytetin tonë, po u shpëgon valltarëve figurat e finales. Mirëpo djali që e udhëheq vallen ka ndrydhur këmbën, kërcen me zor dhe nuk e bën finalen. Përballë meje shoh banakun e klubit që është brenda sallës së provave. Aty është kitaristi me flokë të thinjura dhe një aktor i gjatë që po pijnë konjak dhe bëjnë shaka me bufetjeren, megjithëse regjizori u ka tërhequr disa herë vërejtjen. Në anën tjetër të prapaske-nës, përballë meje, është Donika me librin e fizikës të hapur mbi gjunjë. Po studjon se nesër ka një provim në shkollën e natës.

Hapet dera e sallës dhe hyjnë dy djem të

turnit të dytë. Duan të shohin, po regjizori i nxjerr jashtë se nuk do njerëz të huaj nē prova. Ai ka lejuar të hyjnë brenda vetäm një plakë dhe një djalë i vogël të cilët rrijnë nē një cep të sallës. Plaka éshtë nëna e Vangjelisë dhe pret vajzën pér ta shoqëruar nē shtëpi. Ajo shikon me sy të habitur atë që zhvillohet nē ske-në, dëgjon thirrjet e regjizorit dhe herë pas here ul kokën e dremit disa çaste e mbështjellë me shallin e saj të zi, derisa zëri i regjizorit ose gjë-mimet e lodrës e zgjojnë. Edhe djali, që rri pranë saj, pret të motrën, Serveten. Babai i saj, Sul Berberi, nuk do që vajza e tij të vijë vetäm nē shtëpi, dhe dërgon djalin ta presë dhe ta shoqë-rojë. E pra edhe Vangjelia dhe Servetja kthehen nē shtëpi me shoqet që e kanë rrugën an-dej, megjithatë edhe plaka, edhe Sul Berberi nuk kanë besim dhe duan që ato të vijnë të shoqëruara. Por unë pse i mbes nē qafë dy njerëzve të moshuar, kur edhe Hilmu që éshtë i ri dhe punon si gjeometër nē komitet nuk ka besim tek unë dhe kérkon të heq dorë nga grupei artistik. Sidomos mbrëmë ndodhi që...

Hajde, Neta, ular! Kot po rrij këtu pas ske-nës dhe po mendoj. Pres të më vijë radha të kën-doj këngën tjetër. Si the? A shkoi mirë skeçi ju-aj? Cili, ai pér punën e pajës? Të të them të drejtën nuk e vura re. Jo, jo, këtu isha po nuk e di se si nuk e ndoqa. Kush thérret? Aha, regjizori ankohet se nē prapaskenë bëhet zhurmë. Mirë, po heshtim. Jo, jo, unë do të rrij këtu. Shko ti nē sallë. Nuk kam asgjë. Asgjë fare. Më dhëmb pak koka. Nuk vij. Sa këmbëngulëse je. Mirë atëherë, shkojmë.

Salla është në gjysmë errësirë. Vetëm skena është e ndriçuar. Regjizori rri para avanskenës tek një tryezë e vogël ku ka tekstet, programin dhe shënimet e shfaqjes. Ai lëviz nga vendi pa reshtur, hipën në skenë ose zurret jo nga shkallët por duke kërcyer tek avanskena, sillet në-për sallë, pi cigare, ndërpret aktorët ose këngëtarët dhe, si zakonisht, bëhet nevrik. Kitaristi i thinjur po pi një gotë tjetër konjak. I janë këputur dy tela të kitarës, prandaj nuk i bie por pi konjak tek banaku. Aktori i gjatë është larguar. Tani në skenë po këndon kuarteti i djemve. Sa zëra të mira kanë. Salla buçet. Plaka është zgjuar nga dremitja dhe dëgjon e çuditur kuartetin. Edhe regjizori ka qëndruar në një cep të sallës dhe duket i kënaqur.

Sa shkoi ora, Neta? Tetë e një çerek? Kushe di sa do të vonohemi sonte. E kuptoj, janë ditët e fundit dhe provat janë zgjatur. Si the? A do të vijë Hilmiu të më marrë? Nuk e di... Ndoshta vjen. Them ndoshta sepse... Jo, jo nuk të fsheh asgjë. Jo, pra. Nuk besoni? Si të bëj që të ta mbush mendjen. Nuk e fsheh që ai... Jo, asgjë. Shiko sa e bukur është kjo vjersha që reciton Sokrati... Si thua? Mos të ndërroj bisedë? Nuk e bëra për këtë. Sa këmbëngulëse je, Neta. Nuk e di si të them... Po, po, ke të drejtë. Mbrëmë më ka ngjarë diçka me Hilmion. Ja, dëgjo:

— Kur mbaruam provat, Hilmiu më prishte në krye të rrugës, pak përtej fabrikës. Porsa e pashë, pata menjëherë përshtypjen se ai ishte i mërzitur. Kemi disa muaj të fejuar por njihemi prej kohësh dhe e kuptoj kur është në qejf apo është i mërzitur dhe nevrik. U ndava nga shoqet

dhe iu afrova. Ai foli me vajzat madje iu përgjegj edhe shakave të tyre për të treguar se nuk kishte asgjë por sa u larguan ato, u ngrys.

Binte një shi i imtë, pa zhurmë dhe Hilmiu ishte i lagur. Pardesyja e re i shkëlqente nga pikat e shiut. Qëndruam pak aty pastaj i thashë duke e shikuar buzëgaz:

— Shkojmë apo ke qejf të lagesh edhe më?

Nuk iu përgjegj shakasë sime. As më shikoi. Zumë të ecnim pa folur. Kur dolëm në shesh, papritmas gjëmoi një bubullimë e fuqishme dhe e zgjatur. Pas pak shiu u shtua.

— Eja të hyjmë nën kafene! — tha ai shpejt, pa më shikuar dhe ngriti jakën e pardesysë.

Në lokal ishte qetësi. U ulëm në një cep të sallës pranë dritarës së madhe pasi shkundëm shiun nga pardesytë.

— Tani mbaruat provat? — pyeti ai me zë të lehtë.

U përgjegjja shkurt. E kuptova se pyetja e tij ishte me qëllim. Ai donte të niste bisedën për çështjen e pjesëmarrjes sime në grupin artistik të ndërmarrjes. E kuptova se do të grindeshim.

— Hë, si do t'ja bëjmë punës tënde? — pyeti ai menjëherë.

— Nuk të kuptoj — i thashë, megjithëse e dija se ku e kishte fjalën.

— Mos u bëj naive, — ma ktheu ai, — po të pyes për grupin artistik. Hë, si thua?

Nuk u përgjegjja. Shikova nga dritarja. Aty pa zhurmë rrëshqitnin pikat e shiut duke lënë prapa një vazhdë të ndritur. Njerëzit që kalonin në shesh i shihja turbull si pas perdes së mjegu-

llës. Në lokal herë pas here shfrynte maqina e ekspresit.

Pas një heshtje që zgjati disa caste, ai nisi të flasë:

— Dëgjo, Lume, kjo punë nuk mund të vi-jojë më kështu. Nuk është mirë të marrësh pjesë në grupin artistik. Kuptomë drejt, unë nuk jam fanatik por nuk të ka lezet të dalësh në skenë e të këndosh.

— Pse?

— Ç'është kjo pyetje. Nuk e ke kuptuar se kjo gjë nuk të ka hije?

— Jo.

— Habitem si flet kështu. Ne jemi të fejuar. Pas disa muajsh do të martohemi, kurse ti më thua «pse». A ke menduar ç'mund të thonë bota e në radhë të parë prindët e mi?

— Nuk besoj se kanë çfarë të thonë. Unë punoj në fabrikë, jam maqiniste dhe në orët e lira marr pjesë në grupin artistik. Kam tre vjet që këndoja, më pëlqen kjo gjë, kurse ti vjen e më thua të heq dorë. Kjo mua nuk më duket e drejtë.

Ai u mat të flasë, por atë çast erdhi kamarieri.

— Mua më sill një konjak — tha Hilmiu,

— po ti çfarë do?

— Një kakao.

Në dritare prapë rridhnin pa zhurmë pikat e ujit. Shiu vazhdonte. Njerëzit në shesh duke-shin të mjegulluar. Kaloi një veturë. Dëgjova rrotat e saj duke shushuritur teksha çanin ujin. Në lokal prapë shfryu maqina e ekspresit me dritën blu përpëra.

— Atëherë si do ta bëjmë? — pyeti prapë Hilmiu duke më vështruar ngultas.

Ngrita supet.

— Domethënë nuk do të heqësh dorë, hë?

Prapë nuk fola. Jo se ndruhesha t'ja thoja mendimin tim copë, po nuk më pëlqente ajo bisëdë. E kuptoja se ajo kishte marrë një rrugë të keqe dhe nuk e di si do të përfundonte, se unë isha e vendosur mos të lëshoja pe dhe mos t'i bindesha atij urdhëri.

— Të them të drejtën, nuk e kuptoj këm-bënguljen tënde, Lume, — tha ai pas pak. — Si është e mundur që ti mos t'i vësh veshin fjalëve të mia? Dëgjo, ma thuaj copë: më do më shumë mua apo artin?

— Ç'është kjo pyetje? — u habita unë.

Ai nuk m'u përgjegj por përsëriti edhe një herë atë pyetje. E kuptova edhe më qartë se atë natë diçka do të ndodhë, ndoshta diçka edhe do të prishej, mund të thyhej.

— Po pres përgjegje — tha Hilmiu.

Unë shikoja vijëzat e ujit që zbrisnin tatë-pjetë xhamit. Kamarieri solli porositë.

— Më sill një paketë diamant, — tha Hilmiu duke afruar para vetes gotën e konjakut.

Shiu vazhdonte dhe pas dritäres kalonin herë pas here njerëz. Unë shikoja siluetat e tyre dhe mendoja.

— Ti më pyete a të dua më shumë ty apo artin, — thashë më në fund duke i theksuar mire fjalët. — Sipas mendjes sime nuk mund të flitet në këtë mënyrë, prandaj pyetja jote është e kotë dhe nuk i përgjegjem.

Vura re se fjalët e mia nuk i pëlqyen. Këtë



e dija, dhe nuk u habita. Ai heshti një çast pastaj tha:

— Me sa kuptoju, ti nuk ke ndër mend të heqësh dorë — heshti duke pritur se mos unë thoha gjë dhe vazhdoi duke përbajtur me zor zemërimin e tij. — Atëherë dëgjo: po të vazhdosh, do t'i kemi keq punët bashkë. Mendohu edhe një herë. Unë të dola borxhit. — Fjalët e fundit i shqiptoi me zë të lehtë por duke i shkoqitur mirë. Pastaj piu konjakun.

Në tryezë pllakosi heshtje. Tasi me kakao avullonte duke shpërndarë një aromë të këndshme çokollate. Jashtë shiu vazhdonte, kurse mëqina e ekspresit shfrynte duke lëshuar rrëth vetez një re të bardhë, avulli.

Padashje zuri të më kujtohej tërë historia e fejesës sonë. Ne jemi rritur në një lagje por kurrë s'më kishte shkuar mendja se një ditë mund të fejohesha me të. Kur ma thanë prindët, më erdhi çudi. Jo se ai ishte djalë i keq por nuk ndjeja gjë për të. Megjithatë ata ngulën këmbë dhe unë pranova. Kush mund të mendonte se Hilmiu ishte njeri me ato mendime të mykura në kokë dhe se dashurinë tonë do ta rrezikonte me atë këmbëngulje prej fanatici. Mundet që edhe prindët t'i kenë thënë që të ngulte këmbë për të më larguar nga grupi artistik, por ai duhet të luftonte e t'i bindte se e kishin gabim. Që ditët e para të fejesës pata vënë re se atij nuk i pëlqente që unë të aktivizohesha në fabrikë por mendova se ai do të ndërronte mendim dhe do të bindej. Po ndodhi e kundërtat.

— Po të ftohet kakao — tha ai, pas një heshtje të gjatë.

— Nuk e dua tē nxehhtë.

— Qudi, e pra duhet ta pish tē nxehhtë se i bën mirë zérít.

Nuk fola. Në kafene hynë një grup tē rinjsh duke qeshur e duke folur me zë tē lartë. Zunë vend në një tryezë pranë banakut duke lëvizur karriget me zhurmë.

— Domethiënë nuk kemi më çfarë tē bisedojmë apo jo? — tha Hilmiu duke m'i ngulur systë, — me sa shoh ti nuk pranon tē heqësh dorë.

— Nuk e kuptoj pse duhet ta bëj këtë.

— Sepse dua unë. Nuk tē mjafton kjo arësyé?

E shikova. M'u duk sikur papritur nuk ndohej më në një tryezë me mua por në një vend tjetër, madje në një kohë tjetër dhe zëri i tij më vinte nga larg, si nga fundi i një rrugice tē errët.

— Atëherë? — tha prapë ai.

— Çfarë atëherë?

— Do tē largohesh nga grupi apo jo?

Ngaqë heshta disa herë, ndoshta ai pandehu se unë mendohesha dhe mund tē ndërroja mendim. Prandaj iu përgjegja menjëherë dhe me zë tē plotë:

— Jo.

Prita që tē inatosej tē nxirrte ndonjë marrëzi nga goja, po ai heshti, ngriti gotën e konjakut, fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe u ngrit në këmbë e tha:

— Ikim.

Deshalb t'i them se nuk kishte pushuar shiu por mendova se më mirë t'i jepnim fund asaj bisede tē vështirë.

Duke dalë nga lokali, dëgjova zërat e tē rinj-

ve që përziheshin me njëri-tjetrin dhe zhurmën e maqinës së ekspresit që shfryu edhe një herë.

Shiu nuk kishte pushuar. Rrugët ishin po-thuajse të zbrazura. Dritat e ftohta të neoneve reflektoheshin mbi asfaltin e lagur. Ajri ishte i kulluar, i freskët dhe e thithja me dëshirë. E dija se atë natë në mes meje dhe Hilmiut diçka kishte ngjarë, marrëdhënjet tona do të merrnin një rrugë tjetër e megjithatë isha e qetë, shumë e qetë, ndonëse nuk më vinte mirë. Isha e qetë sepse nuk e ndjeja veten fajtore, e dija se kisha të drejtë. E kuptova që në fillim se lufta që bëra me Hilmiun nuk ishte vetëm për të qëndruar në grupin artistik. Ajo kishte të bënte me diçka tjetër më të rëndësishme. Kërkesa e tij ishte shprehje e një qëndrimi të padrejtë ndaj personalitetit të femrës. Ai qëndrim edhe në të ardhmen do të shfaqej përsëri në forma të ndryshme, në raste të ndryshme duke më urdhëruar që të vaproja se ashtu donte ai.

Ecëm pa folur nëpër rrugët e qeta, në mes të shiut dhe neoneve. Hilmiu ishte i zemëruar, rrinte pak i veçuar. Kur u ndamë, më tha një «natën e mirë» nëpër dhëmbë dhe u zhduk në mes të shiut që e mbështolli në rrjetën e tij të ndritur.

Ja, kjo qe biseda që bëra mbrëmë me Hilmiun. E kuption tani si është puna, Neta? Më thuaj a kam ndonjë faj? Si the? Po ashtu është, ai është sjellë keq dhe ka mendime prej fanatiku. Unë nuk mund ta pranoj kërkesën e tij. Ndoshata kundërshtimi mund të ketë pasoja për mua, ndonjërit mund t'i duket se unë do humbas në këtë mes por nuk është kështu. Nuk humbet gjith-

një ai që duket sikur ka humbur. Përkundrazi, në rastin tim mund të thuash se unë fitoj shumë.

Po më thërret regjizori. Duhet të shkoj në skenë për të kënduar këngën e dytë që kam në program.

Hipa në skenë. Jam gati. Po rri para orkestrës. Pres të nisë muzika e pastaj të këndojoj. Salla éshtë në gjysmë erësirë. Para avanskenës rri regjizori. Ai më tregon nga duhet të hyj dhe të dal në skenë. Kurse tani po më flet për interpretimin e këngës, si duhet të thellohem në përbajtjen e tek-sit dhe çfarë duhet të shpreh me të. Në një cep të sallës shoh plakën që, e mbështjellë me shallin e saj, rri e dremit. Pranë saj éshtë djali, që e ka dërguar i jati të shoqërojë motrën në shtëpi. Pa dashje mendja më shkon tek Hilmiu, tek biseda jonë e mbremshme.

«Kënga jote, Lume, éshtë një hymn i gëzuar. Ajo i drejtohet vajzës sonë që theu paragjykimet dhe po ecën me ballin lart nëpër rrugën e gjërë, të ndritur të jetës».

U shkëputa nga mendimet e kujtimet e mia, dëgjoj me vëmendje regjizorin. Dua që kënga të më dalë sa më mirë, sa më bukur. As sallën nuk po e shikoj më. Regjizori ndez edhe një cingare dhe vazhdon:

«Prandaj interpretimi yt duhet të jetë i gjallë, optimist, kënga të jetë një thirrje e gëzuar dhe njëkohësisht e fuqishme drejtuar të gjitha vajzave tonë që të vazhdojnë marshimin e tyre nëpër rrugën e gjerë e të ndritur të jetës dhe të mos dëgjojnë zërat që vijnë nga rrugicat prej nga disa njerëz e flasin, u bëjnë me shënja, madje edhe i kërcënojnë që të ndërrojnë rrugë dhe

prapë tē futen nëpér rrugicat e errëta, pa krye pér tē ndjekur si manare tē urta e tē bindura burrin, tē fejuarin apo ndonjë tjetër.

Rrij e shikoj me vëmendje regjizorin dhe them me vete: ke tē drejtë, ashtu si thua ti është dhe unë ashtu do tē përpinqem tē këndoja këngën time. Qëparë qeshë e ngashëryer, e shqetësuar. Por tani fola me Netën, po ju dëgjoj juve, shoh në sallë plakën dhe atë djalin e vogël dhe e kup-toj se kam vepruar shumë mirë mbrëmë, duke mos e dëgjuar zërin e Hilmiut që vinte nga rrugica e errët.

Nuk e di a do tē vijë sonte Hilmiu tē më presë pas provave. Dua që tē vijë tē bisedoj prapë me tē. Në qoftë se nuk vjen, nuk kam q'të bëj, ai e ka fajin. Unë nuk do tē shkoj t'i lutem as nuk do t'i bindem kërkësës së tij tē padrejtë. E di, nga qëndrimi im diçka do tē ndryshojë, diçka edhe do tē thyhet. Mundet që pér ndonjërin unë do tē humbas, por po përsëris se jo gjithmonë humbet në tē vërtetë ai që duket sikur ka humbur.

Gati jam, regjizor. Mund tē fillojtmë. Mos u bëni merak, këngën do tē përpinqem ta këndoja si më thatë ju dhe atë do ta këndoja jo vetëm përvete e pér shoqet e mia por edhe pér Hilmiun edhe pér atë plakën e djalin që rrijnë në sallë.

Nisi muzika. E ndjej se ajo më mbështjellë si një erë e freskët, e fuqishme. Para meje nuk kam sallën në gjysmë errësirë por rrugën e gjerë, tē ndritur, tē drejtë. Zëri nga rrugicat e errëta mbeti diku larg.

KAMJONA PERTEJ KUFIRIT

A ha, këtu paskeni qëndruar të na pritni? Keni të drejt, u vonuam. Jo, nuk patëm ndonjë avari rrugës. Maqina është në rregull. Ju nuk e dini çfarë na ndodhi? Nuk ju tha gjë Sadiku? Ku është ai, nuk po e shoh. Mund të jetë larguar, ose është mbyllur në kabinën e kamionit të tij. Mundet. Thashë se ai duhet ta di pse u vonuam, mbasi kamioni ynë ecën pas kamionit të tij dhe atëherë... E shoh se nuk po kuptioni asgjë. Mirë, po ju tregoj si qe puna.

Përpara se të niseshim qëndruam si zakonisht në zyrat e eksportit për të verifikuar ngarkesën. Na vonoi ai magazinieri i gjatë, Muharremi, mbasi kishin lëvizur disa arka me domate dhe njérës i ishte shpërthyer një dërrasë. I rregulluam po Muharremi prapë na vonoi, se bëri një verifikim të dytë. U shamatuam me të, pastaj u nisëm. Ju e dini se kamioni ynë është i fundit dhe ai e mbyll varganin. Kur u nisa, pashë orën. Kishim mbetur njëzet minutë pas kamionit të Sadikut, që udhëtonte para nesh. «Do t'ja shkel gazit dhe do ta mbërrimë» — i thashë shokut tim Gogos. «Do t'i mbërrimë» u përgjegj ai shkurt, ashtu siç flet zakonisht, dhe zuri prapë të lexonte gazeten. Ne të gjithë e lexojmë

gazetën, po nuk kam parë deri tani njeri që ta le-
xojë si e lexon Gogua. Ai i lexon të gjitha, prej
kryeartikullit deri tek programi i radios. Dhe jo
një e dy po të gjitha gazetat pa përjashtim. Kur
shkon jashtë shtetit, porosit njerëzit e shtëpisë t'ja
ruajnë dhe, pasi kthehet, merr tufën e tyre dhe i
lexon me radhë. Nuk e sheh kurrë pa dy-tri gazeta
në xhep ose nëpër duar.

Duke ecur drejt kufirit, hapja sytë për të pa-
rë kamionat. Por asnjeri nga ju as Sadiku nuk
dukej gjékundi. Më vinte të pëlcisja se nuk më
kishte ngjarë ndonjëherë të shkëputeshë nga var-
gani. «Kushedi ç'do të mendojnë shokët për ne»,
thosha me vete. Nja dy-tri herë ja thashë këtë gjë
edhe Gogos, po ai lexonte gazetat qetë-qetë dhe
përgjegjej shkurt: «do t'i mbërrimë». Nuk e fsheh se
më bëri nevrik, dhe u mata t'i shkrehem ashtu ven-
çë, por pastaj heshta pasi ai nuk kishte asnjë faj.

Meqë nuk shikoja asnjerin nga ju, e shtova
shpejtësinë. Mirëpo në një pjesë të rrugës së pash-
truar me asfalt kamioni ynë ra në një gropë dhe na
troshiti keqas. Dëgjova që kërcitën arkat me do-
mate. Gogua ktheu kokën e më shikoi. Unë e kup-
tova shikimin e tij. Nisa të shikoja më me vëmendje
rrugën, po shpejtësinë nuk e ula.

Pas një ure të vogël pamë disa të rinj, që u
ngriten më këmbë dhe na bënë me shenjë të nda-
lonim. Po këta ç'duan? Në fillim mendova të mos
qëndroja, por pastaj hoqa këmbën nga pedali i ga-
zit dhe qëndrova.

— Si është puna? — thashë duke nxjerrë ko-
kën jashtë xhamit të kabinës.

— Dy të rinj erdhën drejt meje. Nga veshja
e tyre e kuptova se nuk ishin fshatarë.



— Lëre, —foli ai që ecte prapa. Kishte zë të ngjirur dhe ishte i ngrysur. — Këta nuk të bëjnë gjë. Mos të humbim kohën kot.

— Prit, — ja ktheu ai që ecte para. Ishte një djalë me trup të imtë, sy të ndritur e vetulla çuditërisht të trasha.

— Hë, si është puna? — i pyeta prapë duke e humbur durimin.

Djali me vetulla të trasha më shikoi ngultas, sikur donte të më studjonte. Ngurroi një çast pa folur, sikur matej, pastaj tha:

— Ne jemi aksionistë. Sot në drekë na janë helmatisur tre shokë. I sollëm nga kodra deri këtu, mirépo tanë nuk kemi si t'i çojmë në qytet për t'i mjekuar.

— E çfarë kërkoni, t'i çojmë ne? — i pyeta unë. U çudita si i thashë ato fjalë me atë ton të ashpër.

— E dëgjon? — foli djali me zë të ngjirur, që rrinte pak i mënjanuar, — edhe ky si ai tjetri.

— Prit — ja bëri djali i parë, që dukej i qetë por këmbëngulës. Pastaj u kthye nga unë. — Shokët janë të sémurë. Këndej nuk kalojnë maqina, sidomos në këtë orë.

— Ne shkojmë jashtë shtetit për të dërguar domate, — i thashë duke kruar kokën.

— E di. Pastaj?

— Si pastaj? Po ne...

Mirépo nuk fola më dhe u bë heshtje. Gogua kishte lénë gazetën dhe ndiqte bisedën tonë. Ai zakonisht është shumë i përbajtur dhe, meqë është më i ri se unë, nuk ndërhysh shumë. Po atë çast u afroa tek dritarja dhe e pyeti djalin me vetulla të trasha, që rrinte i mënjanuar:

— Dëgjo, më bënë përshtypje fjalët që the:
«edhe ky si ai tjetri». Ç'deshe të thuash?

Djali e shikoi vëngër dhe iu përgjegj:

— Para jush ndaluam një kamion tjetër si ky
i juaji dhe i kërkuam t'i conte shokët në spitalin e
qytetit, po shoferi nuk pranoi.

— Cili ishte? — pyeta unë.

— Nuk e njohim — përgjegjji djali me vetulla
të trasha.

«Ka mundësi të ketë qenë Sadiku» thashë me
vete, «ai udhëton para nesh. Megjithatë nuk mund
të jem i sigurtë. Mund të kenë ndaluar ndonjë ka-
mion tjetër. Nejse, kjo nuk ka rëndësi tani për tani.
Si t'ja bëjmë?»

Atë çast u afrua një vajzë me flokë të dendura,
që i binin mbi sy:

— Hë, si thonë? — pyeti dy të rinjtë.

— Të shohim, — u përgjegjën ata gati me një
zë. Pastaj ai me fytyrë të ngrysur e pyeti:

— Si janë shokët?

— Naumi u qetësua pak, kurse dy të tjerët
prapë ankohen nga dhembjet.

Pas këtyre fjalëve ata heshtën. Të tre rrinin e
pritnin. Ktheva kokën dhe u shikuam sy më sy me
Gogon.

— Jemi vonuar, Gogo. Kemi mbetur prapa sho-
këve.

— E di. Pastaj domatet...

— Ashtu është.

— Megjithatë...

— Megjithatë, në djall domatet përpara nje-
rëzve, — shtova duke i rënë me shuplakën e dorës

timonit. U ktheva nga tē rintjtë që rrinini jashtë:
— Sillni shokët, — u thashë.

Të tre u larguan gati me vrap. Dëgjova që djali me vetulla tē trasha diç zuri t'i thotë atij me zë tē ngjirur. Shikova orën. Kishim mbetur më shumë se një gjysmë ore pas shokëve, dhe tanë duheshin më shumë se dy orë pér tē shkuar e pér t'u kthyer nga qyteti. Punë e madhe. Në djall tē venin tē gjitha!

— Rimorkjon po e lëmë këtu — i thashë Gogos.

— Mirë.

— Ti rri e më prit këtu! Do tē kthehem shpejt. Gogua heshti një çast, pastaj më tha:

— Ne vonë që vonë jemi, prandaj mos bëj rrëzira. Ec me mend. Në kabinë ke njerëz tē sëmu-rë.

Unë vura buzën në gaz dhe tunda kokën.

Papritmas Gogua ndërroi bisedë dhe më pyjeti:

— Kush do tē ketë qenë ai shoferi që nuk ka pranuar?

Desha t'i përgjigjem: «Ndoshta Sadiku», por heshta dhe ngrita supet. Nuk e di, por nuk doja tē zija në gojë emrin e ndonjë shokut tonë, se më vinte turp tē mendoja që ndonjëri nga ne tē ishte sjellë në atë mënyrë.

Atë çast dëgjuam zëra. Gogua rregulloi gazetat, i palosi dhe i vuri me kujdes nën sedile. Nja dy prej tyre i futi në xhep. Shikova jashtë. Ata po vinin duke bartur në krahë shokët e sëmurë. Njëri ecte me këmbët e tij kurse dy tē tjerët, një djallë e një vajzë i mbanin pezull,

Gogua hapi derën dhe i ndihmoi të hynin. Vura re se më e rëndë nga të tre ishte vajza. Ajo i kishte humbur ndjenjat, dhe nga goja gjysmë e hapur i dilte një fishkëllimë e lehtë.

— Të hypin djemtë më parë! — u thirra. — Vajzën vëreni përpara!

Pasi hypën të tre, djali me vetulla të trasha m'u afrua e më tha:

— Duhet të vijë edhe ndonjëri nga ne për t'i shoqëruar.

— Le të vijë.

Ai heshti një çast, pastaj shtoi:

— Po ku do të rrrijë?

— Të hypë edhe ai në kabinë. Është e ndaluar të rrinë katër udhëtarë këtu, po në djall rregullat për këtë rast — dhe, pasi thashë këto fjalë, prapë godita timonin me shuplakën e dorës së djathë.

Ai mbylli derën dhe qëndroi pranë vajzës së sëmurë.

— Mund të nisemi? — e pyeta.

Dhe pa marrë përgjegje ndeza motorrin, ktheva timonin, kur Gogua me disa të tjerë zgjidhën rimborkjon.

Duke udhëtar, mësova se ai grup të rinjsh kishin një muaj që punonin në atë fshat buzë kufirit, për të ndërtuar një rezervuar të madh ujitës. Kishin ardhur nga ndërmarrjet e qytetit. Djali me vetulla të trasha quhej Jani dhe ishte marangoz.

— Do të rrini shumë? — e pyeta.

— Derisa të mbarojë rezervuari.

Kamioni ecte me shpejtësi nëpër rrugën e bardhë, që nuk ishte e shtruar. Unë e kisha përshkuar

dhjetëra herë atë rrugë dhe e dija përmendsh, ja njihja çdo kthesë, çdo urë, çdo ngritje e ulje e madje çdo gropë. Ecja shpejt por me kujdes. Nga njëherë shikoja orën. Kishte kaluar ora gjashtë dhe dita e qershorit kishte nisur të thyhej. Rruga ishte e qetë dhe vetëm rrallë takonim ndonjë gaz ushtarak ose ndonjë karrocë.

— Si u helmatisën shokët? — e pyeta Janin.

Nuk e dimë me siguri, po mundet nga mishi që hëngrëm në drekë.

— Jo mundet, po me siguri — foli ai djali që ishte më mirë se dy të tjerët. — Unë e ndjeva menjëherë se mishi kundërmonte një erë të rëndë, po isha i uritur dhe nuk e vura re. Fajin e ka ai furnitori ynë matrapaz, që kushedi ç'ngatërron me mishin dhe ushqimet tjera.

— Nuk e ke keq — pohoi Jani.

Atë çast vajza, që rrinte përpara me kokën mbështetur mbi supin e Janit, lëshoi një psherëtimë të thellë.

— Ç'ke, Irenë? Si ndjehesh? — e pyeti ai me zë të lehtë.

Ktheva kokën dhe vura re se ajo i hapi një çast sytë, pastaj i mbylli prapë. Ishte e zverdhur dhe flokët e dëndura ja qarkonin fytyrën vezake duke lëshuar hije të lehta mbi të.

— Ajo nuk është mirë, — foli djali që rrinte prapa.

— Është më rëndë se ju të dy.

Atë kohë hymë në rrugën e asfaltuar. Pra kishim përshkuar më shumë se tri të katërtat e rrugës. Shtova shpejtësinë. Prapë shikova orën.

— Je vonuar? — pyeti Jani.

— Ç'e pyet! — ju përgjegja duke tundur dorën.

Mendova shokët që kishin kaluar me kohë kufirin dhe po udhëtonin nëpër tokën e huaj për të çuar në destinacion domatet. E merrija me mend sa ishin shqetësuar për vonesën tonë. Megjithatë nuk isha penduar që ndërpreva udhëtimin për të dërguar në spital tre vullnetarët.

— Po Kola si është? — e pyeti pas pak Jani shokun që rrinte prapa.

— Më mirë jam — u dëgjua një zë i ulët.

— Ke dhembje?

— Pak.

Në kabinë ra heshtja. Dëgjohej vetëm uturima e motorit dhe zhurma e rrotave që përpinin rrugë. Nga larg vura re se u duk oxhaku i një fabrike. Ajo ishte shënja e parë, që tregonte se qyteti nuk ishte larg.

— Po mbrrijmë, — thashë duke treguar me dorë oxhakun.

— Nuk dimë si t'ju falënderojmë shoku...

— Vehbi, më quajnë.

— Shoku Vehbi, na bëre një shërbim të madh.

— Asgjë.

Sepse m'u duk sikur ata atë çast po mendonin për shoferin tjeter, që nuk pranoi t'i ndihmonte. Edhe mua më ishte ngulur si gozhdë në kokë ai mendim dhe nuk më linte të qetë, megjithëse në fillim u përpoqa ta largoja. Atëherë pyeta Janin:

— Nuk e morët vesh si quhej ai shoferi që nuk pranoi t'i conte të sëmurët në spital?

— Jo.

— Po më thoni, si ishte!

— Një burrë rrëth të pesëdhjetave, trupmadh, me flokë të prera shkurt.

— Mos i kishte flokët si të kuqërrremta?

— Po.

— Ai paska qenë.

Vura re se Jani më shikoi me vëmendje dhe priti që unë të flisja prapë. Pastaj më pyeti:

— E njeh?

Nuk ju përgjegja. Tani nuk kisha më asnë dyshim. Po, Sadiku kishte qenë që nuk kishte pranuar t'i conte të rintjtë e sëmurë në spital. Më erdhi turp për të, prandaj nuk iu përgjegja Janit kur më pyeti: «A e njeh?» Ç't'i thoja? Ju e dini më mirë se unë se cili është Sadiku. Është punëtor i madh, për te nuk ka lodhje, po ai nuk sheh gjë tjeter përveç punës dhe rrrogës. Aty e ka mëndjen. Të punojë sa më shumë, të marrë sa më shumë. Gjërat e tjera për te nuk kanë rendësi. Sadiku ul kokën mbi timon dhe nuk mendon për asgjë. Bota e tij është e ngushtë sa kabina e kamionit. Edhe sot ai do të ketë menduar: «Ç'më duhet mua të kthej rrugë, të harxhoj benzinë, të vonohem pa lejë, kur nga kjo nuk do të këm asnë përfitim. Pastaj kushedi ç'mund të më ngjasë. Mund të më zërë policia, mund të dëmtohen domatet, mund të anullojnë këtë udhëtim, dhe atëhere do të mbetem pa marrë dietën». Duke arësyetuar kështu, ai nuk ka pranuar dhe është nisur. Punë e madhe se aty ishin tre njerëz të sëmurë, që ndoshta edhe mund të vdisnin. Ai për vete ishte mirë. Punonte sipas rregullave, vazhdonte udhëtimin, conte domatet, merrte dietën për të blerë ndonjë plaçkuri në dje.

— Ç'ke, Vehbi? — më pyeti Jani kur më pa që i rashë me pëllëmbë timonit.

— Asgjë.

— U vonove shumë apo jo?

— S'e kam nga ajo. Si është Irena?

— Njësoj.

Ndërkaq kishim mbërrijtur në periferi të qytetit. Nuk e ula shpejtësinë. I bija burisë pareshtur dhe caja përpara. Në një udhëkryq në hyrje të qytetit, një polic desh të më ndalonte, pastaj pa të rintjetë dhe ma bëri me shenjë të vijoja rrugën.

Në hyrje të spitalit bashkë me Janin ulëm nga kabina Irenën dhe dy të tjerët.

— Tani nisu, Vehbi, — më tha Jani, — i çoj vetë brenda me ndihmën e ndonjë infermieri.

— Hajt, hajt, ec përpara!

Unë isha vonuar që isha vonuar, tani ta çoja deri në fund atë punë. Kur shkoi lata, të shkojë edhe sopata, si i thonë fjalës. Pastaj doja të merrja vesh ç'do të thoshte mjeku për të sëmurët. Ndryshe kjo gjë do më mbeste në mëndje gjithë rrugës. Jani kishte hyrë brenda më ata të tre, kurse unë mbeta në sallonin e spitalit. Nisa të shikoja muret. Pashë tabelën e emulacionit, lexova emra të panjohur, i hodha një sy gazetës së murit që kishte një artikull për festën e Vtit të ri, lexova pa kuptuar asgjë një fletë të shtypur, që jepte këshilla si t'i ruajmë fëmijët nga skarlatina. Shikoja derën pas së cilës ishin të sëmurët dhe mjeku. Pastaj nuk prita më po shkova dhe e hapa.

Mjeku, një djalë i imtë me një fytyrë të vogël dhe gati féminore, më shkoi i habitur. Jani i tregoi se kush isha. E pyeta për të sëmurët.

— Dy djemtë kanë intoksikacion të lehtë.

— Po vajza?

Ai nguroi një çast dhe solli nëpër duar një termometër të hollë. Pastaj tha:

— Ajo éshtë rëndë. — Heshti, na shikoi me radhë të dyve dhe pasi vuri buzën në gaz shtoi, — megjithatë nuk besoj se éshtë në rrrezik.

Mbylla derën dhe përshkova me hapa të ngadalshme sallonin. Duke dalë, pashë prapë atë fletën që jepte këshilla kundër skarlatinës. Tek shkallët dëgjova një hap pas meje. Ishte Jani.

— Ti do të rrish? — e pyeta.

— Pa tjetër.

Para se hypja në maqinë, djali më zuri përkrahur. E kuptova se ç'donte të më thoshte. Nuk e lашë të fliste dhe i thashë:

— Bëju shumë të fala shokëve!

— Dëgjo, Vehbi...

— Sa të kthehem, do t'u them shokëve që janë atje në fshat fjalët që tha mjeku.

Hapa derën e kabinës, hyra brenda dhe ndeza motorin.

— Rrugë të mbarë! — thirri Jani duke tundur dorën. Edhe pasi ktheva maqinën dhe mora rrugën drejt kufirit, nga pasqyra e pashë që ai rrinte në hyrje të spitalit duke ndjekur me sy maqinën.

Gogon e gjeta pranë karrocerisë, të rrrethuar nga të rintjtë. Sa panë kamionin nga larg, u ngritet më këmbë dhe më dolën përparrë. Iu përgjegja pyetjeve të tyre pastaj lidhëm karrocerinë.

— Rrugë të mbarë!

— Mirë ju gjetshim!

Ecëm drejt kufirit thuajse pa folur. Herë pas here shikonim orën. Gogua nuk lexonte gazetat. Përpritur tha:

— Bëmë një punë të mirë sot!

— Shumë të mirë!

Pasi thamë ato fjalë, shikuam njëri-tjetrin në

sy duke bërë buzën në gaz. Shtova shpejtësinë dhe pas pak kaluam kufirin e u futëm në tokën e huaj të mbuluar nga errësira.

Ja, këto desha t'ju tregoja. Tani që më dëgjuat, çfarë thoni? Si the, Thoma? Edhe ti mendon se bëmë një punë të mirë. Edhe ti, Astrit, edhe ju të tjerët? Ashtu është, Malo, këtë gjë do ta kishte bërë secili nga ju. Sadiku nuk erdhi? Po, po, rri i mbyllur në kabinën e tij. Si thua, Mihal? po, ashtu është, sjellja e tij nuk i nderon shoferat tanë. Nejse, do të kemi kohë ta bisedojmë këtë. Tani si thoni, a nisemi? Pa tjetër, do ta fitojmë kohën e humbur. Të gjithë ndër maqina.

Çfarë thua, Gogo? Don ta ngasësh ti maqinën? Jo, jo po vazhdoj umë edhe pak. Të betohem që nuk jam i lodhur, dhe sonte nuk kam gjumë.

Mbylle derën! Të nisemi! Para nesh është kampioni i Sadikut. Ne ndriçojmë me dritat tonë spondin, e rrethojmë me dritë atë, ndërsa vazhdojmë udhëtimin në rrugët e gjata të tokës së huaj të mbuluar nga errësira.

NË HYRJE TË PYLLIT

Një gushkuq i ardhur nga pylli kishte qëndruar mbi degët e mollës. Aty kolovitej duke u mbajtur fort mbi këmbëzat e tij të holla. Ngrinte pareshtur kokën e rrrotullonte anash, cicërinte, shkundej. Për asnje çast nuk rrinte i qetë ai grusht puplash.

Mjeda e shikonte. Kishte ndërprerë mësimin dhe rrinte pranë dritares duke vështruar gushkuqin, që kishte fluturuar nga pylli dhe kishte ardhur tek ai si një motiv i brishtë poetik.

Fëmijët nuk bënин zhurmë. Duke ndenjur prej kohe me të, ata ishin mësuar me ndërprerjet e mësimit që bënte mësuesi i tyre. Nganjëherë ai linte përgjysmë ndonjë mendim, nxirrte një fletore me kapakë të zinj dhe diç shënone në të. Herë të tjera i afrohej dritares, hidhte shikimin jashtë dhe atëherë dukej sikur ikte nga ajo dhomë e madhe që shërbente si shkollë. Por, ja, Colit i ra pena në dysheme. Mjeda ktheu kokën. Shikoi fëmijët të ulur rrreth dy tryezave të mëdha e të rënda prej druri. Ata kishin kthyer kokën nga mësuesi i tyre. Vetëm Coli mbante sytë përdhe.

— Merre penën, Col, — tha poeti. Në dhomën

e madhe ku kishin nisur tē zbrisnin hijet e muzgut vjeshtak, zéri i tij kumboi i qetë.

Nga tryeza e parë një kokë me kaçurela u zhduk një çast poshtë saj, pastaj u duk prapë, dhe një penë e vjetër u vu pranë tē tjerave.

Mjeda u largua nga dritarja dhe nisi tē ecë nëpër dhomë. Pasi e përshkoi fund e krye pa folur, prapë u kthye te dritarja dhe hodhi sytë ja-shtë. Gushkuqi ishte po aty, duke u kolovitür mbi degët e mollës e cicërinte në tē rrallë.

— U ba vonë, fëmijë. Po i japid fund mësimit edhe për sot. Bani detyrat që ju dhashë dhe mësoni, — tha mësuesi duke u kthyer në vendin ku rinte zakonisht.

Fëmijët u ngriten përnjëherësh nga vendet. U dëgjuan zërat e tyre gazmorë që e mbushëm dhomën e madhe, dhe u duk sikur atë çast hijet e muzgut u larguan dhe u strukën tëpër cepat e mureve. Dyshemeja e motshme ushtoi nën këmbët e tyre. Mjeda i shikonte buzëgaz. Ishte gjëzim i madh për te kur dëgjonte gjallërinë e atyre fshatarakëve tē vegjël, që vinin aty çdo ditë për tē mësuar. Shkolla që kishte hapur poeti, vërtet nuk ishte e plotë dhe nuk zbatonte programet e Ministrisë së Arësimit, por punën e bënte. Ai kishte bërë disa kërkesa që tē hapej shkolla në atë fshat, dhe nuk kishte marrë përgjegje. Atëhere i ishte vënë vetë punës, kishte mbledhur fëmijët, kishte blerë me tē hollat e veta fletore, lapsa e disa libra dhe u bënte mësim. Për tē ishte gjëzim i madh kur shikonte kokat e tyre tē vogla tē përkulura mbi tryezë, duart që shtrëngonin lapsat dhe ftyrat e tyre tē zgjuara. Atij i bëhej zemra mal kur

vinte re se si mbi letrat e bardha vijëzat e ndryshme bashkoheshin e bëheshin shkronja e pastaj fjalë. Kur u fliste për natyrën, për historinë, për malet, lumenjtë e fushat e Shqipërisë, shikonte sytë e fëmijëve të etuar për dije, që ngjanin si dritare të hapura gati për të pritur dritën.

— Natën e mirë, zotni! — ushtuan me radhë zërat e fëmijëve.

Ai kishte zënë vend afër prakut dhe u përgjegjëz buzëgaz, ndërsa dora e tij e madhe, e fryrë, me gishta të shkurtër mbështetej mbi kokat e tyre, tekxa kalonin duke kapërcyer prakun e derës. Pas pak oborri u mbush me zërat e tyre të kumbushëm. Gushkuqi heshti dhe rrinte e i shikonte duke lëvizur pareshtur kokën.

Në dhomë mbetën pesë fëmijë. Ata mblodhën librat e fletoret dhe rrinin pranë njëri-tjetrit duke pritur të heshtur.

Poeti nisi të shkruajë diçka në fletoren me kapakë të zinj. Fëmija e fundit që kaperceu pragu i thirri një shokut që kishte kaluar përpara. Gushkuqi u tremb, hapi krahet dhe fluturoi prapë në drejtim të pyllit. Atë çast Mjeda mbylli fletoren dhe qëndroi i menduar. Pastaj diçka iu kujtua. Futi fletoren në xhep dhe u kthyte nga fëmijët:

— Shkojmë, — u tha.

Duke ecur nëpër rrugët e fshatit, ai vinte re mbrëmjen, që pak nga pak po pushtonte gjithësinë. Ajri ishte i tejpashëm dhe i freskët. Qielli i mbuluar aty-këtu me re të errëta, vinte e bëhej i bruzët si ujët e një lijeni, kur mbi të zbrësin hijet e para. Ai ecte ngadalë i ndjekur nga

fëmijët. Këmbët i shkelnin herë pas here gjethet e thata, që era e vjeshtës i shkëpuste lehtazi nga pemët dhe ato, pasi bënин disa rrrotullime, shtroheshin në tokën e njomur nga shirat. Poitet i pëlqente ajo shëtitje që bënte çdo mbrëmje. Edhe kur nuk i shoqëronte fëmijët nëpër shtëpitë e tyre, dilte shpesh dhe endej fushave. Me gjithë kënaqësinë e madhe që ndjente kur ishte me vogëlushat, një mendim i zymtë ja prishte tërë gëzimin e atij atrimi me natyrën. Ai i shoqëronte fëmijët nëpër shtëpitë e tyre, se prindërit i kishin lejuar të venin në shkollë me atë konditë. Ky grup i vogël fëmijësh ishin pjesëtarë të familjeve që ishin në gjak, dhe prindërit druheshin t'i linin të shkonin e të ktheheshin vetëm në shtëpi. Që mos të mbeteshin pa shkollë, poeti u kishte premtuar që t'i shoqëronte çdo mbrëmje. Mendimi se mbi ata çunakë të zgjuar rrinte pezull hija e vdekjes, e trishtonte Mqedën, ashtu siç e trishtonte tërëjeta e fshatarëve e mbushur me vuajtje e me skamje të përhershme.

Ai përshkonte rrugët e fshatit pa u ngutur dhe mendime të zymta i vërtiteshin në kokë. Fëmijët i vinin pas pa folur. Hijet e mbrëmjes sa vinin shtoheshin, dhe në fshat dëgjoheshin zhurma e zëra të ndryshëm. Ai ecte dhe mendonte.

- Tashti të nisemi për në shtëpinë tënde, Mir.
- Kemi për të ba nji copë rrugë, zotni.
- E di, nuk asht hera e parë që të përcjell.

— Mund tē shkoj vetëm. Mos u mundoni kot. Nuk kam frikë.

Këtë bisedë bënë atë mbrëmje poeti dhe djalë që kishte mbetur i fundit. Të tjerët ishin nëpër shtëpitë e tyre. Mbrëmja ishte shtyrë, dhe nata po afrohej pa zhurmë si një mace e zezë. Herë pas here dëgjohej një zë që thërriste dikë në fushë ose tingëllima e zileve të bagëtive. Në tē rrallë takonin ndonjë fshatar që kthehej. I dërmuar nga puna e rëndë fshatari tërhiqtë bran këmbët dhe e përshëndeste me nderim poetin.

Shtëpia e Mirit ishte në tē dalë tē fshatit dhe ngrivej mbi një sop tē vogël. Kur e shikoje, ngjante sikur ishte vazhdim i shkëmbit. Aty banonin njëzet e gjashtë njerëzit e familjes së Markajve, që ishin tē njojur në tërë krahinën si njerëz tē ashpër e gjaknxehtë. Ishin në gjak me shumë shtëpi dhe vazhdimisht vritnin ose vriteshin e megji-thatë, nuk shuheshin po madje dukej sikur as pakësoheshin. Nga tetë vëllezër kishin mbetur katër, por fëmijët e vëllezërve tē vrarë rriteshin dhe, pa u mbirë akoma mustaqet, endeshin me pushkë krahëve. Pa mësuar ende par mendën, dinin tē që-llonin. Nga tërë ata njerëz me sy tē gjallë e hundëkrrut, vetëm Miri ndryshonte. Ai ishte i zgjuar, i butë e i sjellshëm. Nuk grindej kurrë me shokët, megjithëse nuk ishte më pak trim se tjerët. Mjeda i thoshte gjyshit tē tij:

— Miri asht trim si ju, por asht i zgjet dhe i butë. Duket se ka ngjarë nga e ama.

Plakut shtatëdhjetëvjeçar i vinte mirë që ja mburrte nipin, po edhe i vinte inat që i thoshte se ngjante nga e ëma.

— Eh, mor dom Ndre, — ja kthente ai, — le t'i ngjajë nanës për mend, nga trimëria dua që të jetë si fisi ynë. Nuk ka randësi mendja por gishti.

— Mirëpo gishtin e urdhënon mendja.

— Jo, e urdhënon zemra, — ngulte këmbë plaku.

Dhe kështu vijonin të bënин fjalë duke u përpjekur ta mundnin njëri-tjetrin, se plakut s'ja hante qeni shkopin dhe përgjegjet i kishte në majë të gjuhës.

— Si asht tata Mark? — e pyeti poeti djalin teksha ecnin.

— Gjallë, — përgjegji ai shkurt.

— A ankohet nga ndonji sëmundje?

— Për t'u ankue ankohet, por jo nga sëmundjet.

Mjeda vuri buzën në gaz. I pëlqeu shumë përgjegja e atij çunaku të zgjuar, që e zbulonte mirë karakterin e plakut të ashpër e idhnak.

Duke biseduar kishin mbërrijtut në hyrje të pyllit, që duhej ta përshkonin pér të shkuar në shtëpinë e Markajve. Të dy heshtën, dhe pas pak poetit iu duk sikur dëgjoi një zhurmë të dyshimtë. Qëndroi. Edhe djali u ndal pas tij. Mbajtën vesh duke ja ngulur sytë errësirës. Panë vetëm hijet e zeza të pemëve, që përziheshin me njëra-tjetrën duke krijuar një masë të madhe amorfë.

— Kush asht aty? — thirri Mjeda.

Nga pylli nuk u dëgjua asnjë zë. Nga larg erdhi në veshët e tyre lehja e zemëruar e një qeni. Pastaj prapë heshtje.

— Kush asht aty? — thirri prapë ai. — Në qofsh burrë, përgjegju dhe dil përpara!

Papritmas zuri të ecë brenda pyllit.

— Zotni... — tha Miri me zë të lehtë.

— Rri aty e më prit, — i tha ai dhe vijoi të ecë. Pas një shkurre dëgjoi zhurmë.

— Kush je ti aty? Dil, mos u fshih! Unë jam Ndre Mjeda.

Priti pak. Pas shkurrez dëgjoi që diçka folën ndër vete dy njerëz. Pastaj degët e shkurrez lëvizën dhe së andejimi dolën dy burra. U bë një pushim i gjatë. Dy burrat qëndruan pranë shkurrez pa lëvizur. Mjeda shkoi drejt tyre.

— Mirëmbrama. Si jeni?

Ata nuk u përgjegjën. Në errësirë poeti nuk ua dalloj dot ftyrat. Vuri re se ishin të armatosur. E kuptoi menjëherë qëllimin e tyre.

— Kush jeni ju? Ç'kërkoni?

Njëri prej tyre psherëtiu thellë dhe e goditi tokën me këmbë plot zemërim.

— Mos e zgjat, dom Ndre, — tha në fund njëri prej tyre, që i merrej pak goja.

— Ç'të bajmë se ishte me ju... — përgjegji tjetri dhe prapë goditi tokën me këmbë.


Mjeda i dëgjoi me vëmendje, pastaj e pyeti atë që foli i pari.

— Ti, Kolë Lleshi je?

Përgjegja vonoi. Pastaj ai që i merrej goja tha një «po» të shkurtër e të thatë. Menjëherë shtoi:

— Shkojmë, Marash!

— Qëndroni, — tha poeti dhe zëri i tij tingëllói i fortë. — Më parë dua të di, pse na zutë rrugën sonte? Hë, si thue, Kolë Lleshi? Fol edhe



ti, Marash Gjoni, e mos i bjerë tokës si kal i haz-disur. Folni, pse na dolët në pritë?

Dy burrat nuk folën. Pastaj Kola tha:

— Ti e di.

— E di por, kam qejf ta digjoj nga gojë juej, për ta kuptue ma mirë se si deshët të shitnit trimni me nji fëmijë.

— Dom Ndre...

— Ai asht nipi i Mark Gjetës dhe nuk asht fëmijë, — tha Marashi dhe prapë goditi tokën me këmbë.

Mjeda u kthye dhe i bëri zë Mirit. Djali nuk ju përgjegj, as nuk lëvizi nga vendi.

— Eja këtu, mos ki frikë!

Kur djali ju afrua, Mjeda i vuri dorën mbi kokë dhe ju kthye dhe u tha:

— Ky asht burri, që ju sonte donit...

Kol Lleshi e kuptoi talljen e poetit, megjithatë u përgjegj:

— Edhe ky ka gjak të Markajve ndër deje. A e di sa njerëz të fisit tim kanë vra Markajt?

— Po nga fisi im? — shtoi Marashi.

— Mirë, po ju sa keni vra nga Markajt? — i pyeti poeti.

Në pyll u dëgjua era, që tinxisht rrëshqiti nëpër degë e gjethë, si një kafshë dinakë që pret të hidhet mbi prenë. Poeti ndjeu se djali u afrua më pranë tij dhe u struk. Era kaloi pranë tyre, i mbështolli me frymën e saj të ftohtë, pastaj iku tutje dhe pylli heshti.

— Ç'bani kështu? — tha Mjeda dhe zëri i tij

papritmas ishte bërë i trishtueshëm, i lodhur. — Jemi të gjithë shqiptarë e rrijmë e vritemi me njeni-tjetrin. Atë që nuk mbërrijtën ta bajnë të huajt, sëmundjet e uria, po e bajmë ne me dorën tonë. Ku po shkojmë kështu?

Dy burrat nuk iu përgjegjën. Prapë u dëgjua era, kësaj here më e fortë. Tre burrat dhe djali rrinin në hyrje të pyllit duke dëgjuar erën që e bënte pyllin të ushtonte.

— Dëgjo këtu, dom Ndre, — tha Kola. Dukej i ngashëryer, dhe goja iu muar më shumë. — E ke kollaj të flasësh ti. Por, më dëgjo nji herë mue. Para dy muajsh babai i këtij djali vrapo vëllain tim të vetëm, Shpendin. Ai kishte nji vjet që ishte martue dhe, dy ditë para se ta vritnin, e shoqja i lindi një djalë si top. Pa u çue sofra e gëzimit të lindjes, u shtrua sofra e zisë dhe gjysmën e berrit që therëm e hëngrëm pér gëzim, e gjysmën tjetër pér mort. U bëra si i çmendun. Prej asaj dite nuk kam ba gja tjetër veçse ruej Markajt, pér të marrë hak. Kam shumë ditë që nuk shkoj fare në shtëpi po sillem rrëth kullës së Markajve. Por, deri tash nuk kam takue asnjërin prej tyne. Sot më thanë se djali i vrasësit të tim vëllai shkon në shkollë dhe kthehet vonë në shtëpi. Nuk pyeta ma gjatë, po mora këtë mikun tim që ka edhe ai gjak pér të marrë tek Markajt dhe zumë pritë.

Mjedës iu kujtua Shpendi. Ai kishte qenë vetë pér ta varrosur. Në sa varrime të tillë kishte marrë pjesë ai! Sa herë i kishte qëlluar që të kishte futur në dhe meshkujt e fundit të familjeve. Ai kishte para syve gratë me një grumbull fë-

mijësh rrëth vetes që, të heshtura, me sytë të mbushur me një pikëllin të pafund, përcillnin pér në varr burrat.

Prapë u dëgjua zëri i fortë i erës. Kësaj here ajo ishte më kërcënuese dhe paralajmëronte stuhi. Mjeda ndjeu se trupin ja përshkuan mornica të shpeshta. C'ishin ato? Kishte të ftohët, apo diçka tjeter e bënte të dridhej? Fërkoi flokët e Mirit dhe vuri re se edhe ai dridhej, se era hynte lirisht poshtë këmishës së tij të vjetër e të arnuar dhe jelekut që nuk kishte asnë komçë.

— Shkojmë, Mir, — tha poeti me zë të lehtë që sa mezi u dëgjua.

Djali tundi kokën dhe ai e ndjeu këtë lëvizje të kokës, se mbi të kishte mbështetur dorën e tij të madhe.

— Dëgjo, zotni..., — tha Kola, — mos i thuej askujt pér këtë që ndodhi sonte.

— Mirë.

— Edhe nji gja tjeter: po të jetë pér mua e pér Marashin, mos e përcill ma këtë djalë në shtëpi. Nuk asht nevoja.

— Natën e mirë, — tha poeti. Zëri i tij ishte i lodhur dhe dukej sikur vinte nga larg.

Ai donte të largohej, se vazhdimi i bisedës do të qe i rëndë pér të. Ata do ta pyesnin, do t'i thonin gjëra, të cilave ai nuk do të dinte si t'u përgjegjëj e ç'tu thoshte, andaj shpesh ngrinte supet dhe trishtohej. Kjo i ndodhë kur fshatarët i ankokeshin pér të zezat e bajraktarëve dhe të priftërinjve, që i shfrytëzonin, i mashtronin.

— Natën e mirë! — u përgjegjën dy burrat.

U ndanë. Poeti dhe djali u futën brenda pyllit, kurse dy të tjerët shkuan në anën e kundërt.

Era u shtua. Tani nuk frynte më me vulle por e pandërprerë. Mbi qiellin e fshatit u mblo-dhën re të ngarkuara me shi. Një rrufe shqeu errësirën, dhe një gjëmim i rëndë u dëgjua anëmbanë. Poeti e djali panë pyllin, që u shfaq pa-pritmas para tyre. Drita e madhe ua lëbyri sytë.

— Luaji kambët, Mir!

Ai shpejtoi hapat dhe djali, që e kishte zë-në përdore u përpoq t'i shkonte pas.

— A ke ftohët?

— Jo, zotëri.

Duke ecur nëpër pyll, në mes të rrufeve e gjëmimeve, poetit iu kujtua gushkuqi, që atë pas-dite kishte qëndruar në degët e mollës si një motiv i brishtë poetik. Tani gushkuqi ishte zhdukur diku thellë, sepse stuhiçë i dalin në ballë të tjerë shpendë me krahë të fortë e të patrembur.

Vijuan të ecnin. Poeti ishte i kredhur në mendime të zymta dhe një pikëllim i madh i rëndonte në shpirt. Vetëm një mendim ja ngronte zemrën. Miri mbante ndër duar libra ashtu si djemtë e tjerë të fshatit dhe kjo do të ndihmonte që ai edhe të tjerët mos t'u ngjanin prindërve, por diçka të ndryshonin në atdheun e lashtë. Ai nuk e kuptonte se vetëm librat nuk ishin të mjaftueshme; ato ndihmonin, por duhej diçka tjetër për ta çarë errësirën e dendur.

Më në fund dolën nga pylli. Atë çast zuri shiu, një shi kokërrmadh. Para tyre u shfaq hija e zezë e kullës së Markajve. Shpejtuan hapin dhe pas pak mbërrijtën tek dera. Poeti ngriti dorën dhe trokiti.

LINDJA E PARË

Shtëpia e lindjes u hap në fillim të vjetrës. Ishte një ndërtesë e thjeshtë me tri dhoma, njëra prej të cilave do të bëhej dhoma e lindjes. E ngritën afër qendrës së fshatit, aty ku në një krah ishin zyrat e kryesisë së kooperativës, në krahun tjetër depot e drithrit. Kur mori vesh këtë gjë, magazinieri Uk Gjeta, një beqar i motshëm që njihej në tërë fshatin për gjuhën e helmatisur, tha me atë zërin e hollë që kanë zakonisht qoset:

— Hë, ç'do të shohim tejatro tashti e tutje!

Përveç mamilës që pritej të vinte nga qyteti, kryesia vendosi që atje të punonte Mara, një plakë e ve që rronte fillikat pasi dy vajzat i kishin martuar. Kur e thirri kryetari dhe ja tha atë gjë, Mara e shikoi e habitur dhe e pakënaqur.

Aty do të punojë një mami që do të vijë këto ditë nga qyteti, kurse ti do të pastrosh e do të gatuash.

Mara i tha se kot e kishin hapur atë shtëpi, pasi aty nuk do të vinte asnje grua për të lindur.

— Në fillim do t'u vijë zor por pastaj do të mësohen, — tha kryetari.

— Po ti e di si janë gratë e fshatit tonë, mor Gjon. Ato përpara, kur u vinte koha pér të lindur, shkonin në pyll dhe atje e nxirrin fëmijën në dritë.

— E di, edhe unë vetë atje kam lindur, — tha Gjoni me një buzëqeshje të hidhur. — Kjo ndodhë para çlirimt, kurse sot gratë lindin nëpër shtëpiat e tyre.

— Ka edhe nga ato që fshehtaz shkojnë në pyll, kur u vjen koha pér t'u liruar.

Gjonit nuk i erdhën pér shtat ato fjalë. Mara bëri edhe një vërejtje tjetër:

— Edhe vendi ku e kini ndërtuar atë shtëpi ...

Gjoni e ndërpren:

— E kuptova, Marë. Atëhere u morëm vesh. Nesër paraqitu atje të fillosh punë. Pér të tjerat mos u bëj merak, kujdesemi ne.

Të nesërmen, megjithëse pa qejf, Mara shkoi në shtëpinë e re dhe nisi ta lajë e ta pastrojë. Pér një javë erdhi mamia. Quhej Sulltane dhe nuk ishte e re. Kishte një trup të ngjallur, të flaskët, fytyra e rrumbullakët dhe dy sy me një ngjyrë të papërcaktuar e fare pa jetë. Ishte e ngadalshme dhe gjithmonë dukej e përgjumur. Porsa erdhi, zuri dhomën më të hyrë pér vete, atë që i kishte dritatet nga pylli, pastaj mori një karrige dhe shkoi u ul në oborrin e shtëpisë me duart mbështetur ndër faqe. Të nesërmen rregulloi dy dhomat e tjera, shtroi çarçafët e bardhë dhe vuri në një raft ilaqet e veglat dhe përsëri doli në oborr,

ku qëndroi për orë të tëra me fytyrën në mes të duarve. Kur e shihje, nuk merrej vesh a mendonte apo dremiste.

Marës nuk i pëlqeu aspak Tanja (kështu kishte qejf ta thërrisnin) Plaka nuk lidhte miqësi shpejt dhe as nuk shquhej si njeri i perzëmert, por ajo grua e ngjallur, që nuk nxirrte Mizën nga qulli dhe gjithë ditën dremiste në oborrin e shtëpisë së lindjes, nuk të bënte fare për vete, madje të inatoste.

Brenda javës Tanja u shkoi në shtëpi dy grave shtatzëna, u dha disa këshilla dhe u tha disa fjalë të thata, që të shtroheshin në shtëpinë e lindjes kur t'u vinte koha, pastaj e kënaqur nga puna e bërë shkoi e zuri vend në oborr me fytyrën mbështetur në mes të duarve.

Kaluan edhe disa ditë. Mara mori vesh se gjatë asaj kohe dy gra kishin lindur në shtëpi. Ja tha këtë gjë Sulltanes po ajo nuk foli fare, vetëm ngriti supet.

Ditët që erdhën nuk sollën asnje ndryshim. Asnjë grua nuk shkeli në shtëpinë e lindjes. Çarçafët e shtretërve rrinin të paprekur. Edhe ilaçet nuk ishin hapur fare. Dhoma e lindjes ende nuk kishte dëgjuar zërin e ndonjë foshnje. Ajo shtëpi e ngritur në mes të fshatit ishte e heshtur, si një vend i pabanuar dhe në oborrin e saj luanin gjethet e thara, që binin nga pemët si flutura të verdha.

Por, ja, nga fundi i shtatorit çdo gjë ndryshoi papritmas. Kjo ndodhi një të hënë. Në fshat u kthyen tri vajza, që kishin bërë një kurs specializimi bujqësor në qytet. Në mes të tyre ishte

edhe Filja, sekretarja e rinisë së fshatit. Ajo njihet nga të gjithë si vajzë e shkathët, e papërtuar, shpuzë e gjallë që, kur merrte përsipër ndonjë punë, do ta çonte deri në fund dhe nuk përtonte të ngatërronte qetë me cilindo. Nuk kishte mbledhje, fushatë, aktivitet që bëhej në fshat ku ajo mos të merrte pjesë. Kur ishte fjala për rininë e sidomos për çështjen e grave, Filja luftonte me të gjitha forcat dhe grindej me ata që bëhen shin pengesë, me burrat dhe me vetë kryetarin e kooperativës, po ta lypte nevoja. Në mbledhje apo biseda fliste me zë të lartë dhe çfarë mendonte e thoshte troç, pa dorashka.

«Kjo sekretarja e rinisë do të mbesë pa maturar» thoshte me gjuhën e tij të helmatosur Uk Gjeta. «Nuk ka njeri që do të fusë zjarrin në shtëpi.» Këto fjalë ai ja pëshpëriste me zë të lehta ndonjë miku të ngushtë, se po ta merrte vesh Filja, atëhere...

Porsa u këthyenë fshat, Filja pyeti për shtëpinë e lindjes dhe kur mori vesh se ishte hapur, u gëzua shumë, pasi edhe ajo kishte luftuar e ishte përpjekur për të. Të hënën në mëngjez ajo shkoi në kryesi, bisedoi me kryetarin dhe me sekretarin e partisë, pastaj pa e zgjatur mori rrugën dhe shkoi në shtëpinë e lindjes.

Sulltanen e gjeti në oborr. Mara ishte ulur në shkallët e hyrjes me duart e kryqëzuara në kraharor.

— Hë, si shkojnë punët? — e pyeti maminë.

— Mirë — përgjegji Sulltanja duke e shikuar ftohët me sytë e saj të qetë.

— Sa gra kanë ardhur për të lindur deri ta-

ni? — pyeti pas pak Filja duke e shikuar ngultas maminë.

Ajo ngriti supet.

Filja përsëriti pyetjen. Atëherë Mara tha:
— Asnjë.

Sekretares i flakëruan sytë nga inati dhe i shfryu Sulltanës.

— Po ti, çfarë ke bërë? Pse të kanë prurë këtu, për verim apo të shullëhesh në diell?

Mamia e shikoi e habitur. Deshi ta pyesë cila ishte ajo, por u pendua dhe heshti.

Filja vazhdoi duke folur me zjarr:

— Si mendove ti, se këtu, në fshatrat e largëta të malësisë, ku ka fanatizëm dhe zakonet e këqia nuk janë zhdukur, do ta gjeje gjithshka fushë me lule? Mos kujtove se gratë tona do të vinin vetë këtu pa bërë asnjë punë ti, pa u munduar, pa luftuar?

Më në fund Sulltanja u përgjegj me një zë të ulët, duke ngritur supet:

— Ç'të bëja unë? Gratë nuk duan të vijnë për të lindur këtu. Unë gati kam qënë. Pastaj, me dy prej tyre kam folur vetë, por nuk kanë pranuar. Ç'të bëja unë?

Atëhere Files i kërceu gjaku në kokë dhe i foli rëndë. Sulltanja e shikonte me sy të zmadhuar nga habia dhe një i kuq i lehtë ja mbuloi mllëzat e flashkëta, tërë mish.

— Po me Gjokën a ke folur? — e pyeti Filja pas pak.

— Me Gjokën?

— Po pra, me sekretarin e partisë?
Sulltanja prapë ngriti supet.

— E shikon? Asgjë nuk ke bërë. Po me cilin do ta zgjidhje këtë punë më mirë se me partinë?

— Po edhe ai nuk ka ardhur të pyesë, — tha me një farë gjallërie Sulltanja, e cila gjeti se ku të kapej.

— Gjoka do të kishte bërë mirë të vinte, por ai është i zënë me njëmijë punë prandaj duhet të shkoje ti tek ai, mos t'i shqiteshe, t'i thoje të bënte mbledhje me burrat që i pengojnë grataë të vijnë këtu. Kështu duhej të kiske bërë, po qe se të digjte puna.

Mamia nuk diti çfarë të përgjegjej.

Filja vazhdoi:

— Ti nuk e di sa jemi përpjekur për ta hapur këtë shtëpi në fshatin tonë. Krahina jonë ka qindra fshatra dhe të gjitha përnjëherësh nuk bëhen. Dhe ja, e hapëm, kurse mamia po rri e vret miza. A e ke pyetur ndonjëherë nënë Marën si kanë pasë lindur gratë në fshatin tonë para çlirim? Po ta them unë po nuk e dite: ato lindnin në pyll. U vinte turp ta nxirrin fëmijën në dritë në sy të njerëzve. Kur u vinte koha, shkonin fshehurazi në mes të shkurreve, vuannin fillikat, nganjëherë edhe vdisnin pa patur njeri pranë. Këto zakone të poshtëra, këto ligje të egra ua kishin ngulitur në shpirt banorëve të këtyre vendeve bajraktarët, priftërinjtë e gjithë dreqërit e tjerë. Pyete nënë Marën, pyete dhe do të mësosh shumë gjëra.

Filja ktheu kokën dhe shikoi Marën që rrinente para hyrjes. Fytyra e saj qëndronte e palëvizur, si një maskë. Por në sytë e thellë lexohet-

shin tërë vuajtjet që kishte hequr në jetë ajo planë e mirë. Dy vajzat e saja Mara i kishte lindur në gëmushat e pyllit, larg syve të njerëzve, pastaj me foshnje të mbledhur me lecka ishte kthyer natën vonë në fshat, duke hequr këmbët zvarrë e duke u mbajtur nëpër trungjet e pemëve që mos të rrëzohej për tokë. Përveç këtyre vuajtjeve të mëdha, ajo kishte duruar edhe sharjet e fyerjet e vjehrrës e të burrit, ngaqë kishte lindur vajzë. Madje, i shoqi, kishte dashur ta ndante sepse nuk i kishte bërë djem. Por s'kishte arriut se e kishin vrarë njerëzit e bajraktarit, dhe Mara nuk ishte ndarë. Ajo i rriti dy jetimet me mundimin e krahëve. Vetëm tani në pleqëri plaka kishte parë ditë të bardha. Vajzat i martoi me dy djem të mirë, dhe vetë jetonte e qetë, megjithëse vetëm.

— Ke punuar shumë keq, — i tha pas pak Filja mami. — Nuk e ke çarë kokën për asgjë. Por unë nuk do ta lë punën me kaq. Ky ujë i amullt duhet të lëvizë.

Dhe iku. Sulltanja e ndoqi me sy, pastaj pak kthyer kokën e pyeti Marën:

- Kush ishte ikjo?
- File e quajnë. Është sekretarja e rinisë.
- Më foli shumë rëndë.
- Kështu e ka ajo. Flet rëndë por thotë fjalë me vend.

Sulltanja desh t'i përgjigjej, pastaj u pendua dhe nuk e hapi gojën. Qëndroi ashtu pa lëvizur dhe pas pak nisi përsëri të dremisë.

Që nga ajo ditë Filja nuk ndënji një çast e qetë dhe nisi të merrej shumë me shtëpinë e lin-

djes. Në fillim foli me Gjokën. Ai i dha fjalën që do të interesohej më shumë, që fshatarët të çonin gratë shtatzëna pér të lindur atje. Pastaj ajo shkoi e foli vëtë me nuset dhe me vjehrrat e tyre. Të gjitha e dëgjonin në hechtje dhe në fund i thonin disa fjalë të përgjithshme, pa i premtuar asgjë. Shumica e tyre thonin këto fjalë: «Të vijnë gratë e tjera, pastaj shohim e bëjmë. Ndoshta atëhere do na mbushet mendja edhe neve».

Kaluan ditë të tjera. Ndërkaq vjeshta kishte zbritur nga malet dhe ishte shtrirë në tërë krahi-nën. Ranë shirat e para e moti u ftoh. Pemët u zhveshën dhe gjethet e thara prapë luanin të qeta në oborrin e shtëpisë së lindjes, e cila ishte gjithmonë e heshtur, ashtu si përpara. Sulltanja veshi fanellën e trashë dhe u mbyll në dhomën e saj. Aty zinte vend para dritares me fytyrën në mes të duarve dhe me shikimin e qetë mbërthyer nga pylli i zhveshur, që niste pak përtëj shtëpisë së lindjes.

Filja nuk shkoi më aty, as nuk foli me mami-në por përpjekjet që të shkonin gratë pér të lindur aty nuk i ndërpren pér asnjë çast. Pranë shtëpisë së saj banonte familja e Lazër Mëhillit dhe nusja e djalit të tij pritej që ato ditë të lindte. Filja e dinte këtë gjë ndaj shkonte shpesh aty. Plaku Lazër, që para pak vitesh kishte qenë shërbëtor i priftit, ishte njeri i ashpër, fanatik i madh dhe vizitat e sekretares së rinisë nuk i shihë me sy të mirë. Filja e dinte këtë gjë, megjthatë nuk e çante kokën dhe i thoshte edhe djalit, edhe Lazarit vetë që Dilen ta çonin pér të lindur atje, në atë shtëpinë e re. Plaku i nxirrte disa shkaqe të

kota, përmendte shumë herë perëndinë, dhe Filja ja lexonte në sy se ai nuk do ta lejonte nusen të shkelte atje. Vajzës i vinte të pëlciste nga inati, megjithatë nuk jepej, dhe vijonte përpjekjet. Ajo e dinte se ishte puna sa të thyhej akulli, të shkonte atje gruaja e parë për të lindur se pastaj do ta kishin më lehtë.

Një ditë me shi Filja, si mbaroi punën, u kthye në shtëpi. Ishte pasdite vonë dhe hijet e para të muzgut po shtriheshin ngadalë. Ajo hëngri bukë, shkëmbeu disa fjalë me të ëmën dhe u nis për në shtëpinë e Lazër Mëhillit.

Njeriu që takoi të parin ishte plaku. Filja vuri re se ai u shqetësua porsa e pa. Kjo e bëri të mendojë se diçka kishte ngjarë. Desh të hyjë brenda, por Lazri nuk e la.

— Si është Dila? — pyeti ajo menjëherë duke i mëshuar zërit.

— Nusja është si kokrra e mollës.

— Më lër të shkoj ta pyes vetë.


— Nuk është në shtëpi.

— Po ku është?

Plaku u ngrys në fytyrë dhe u përgjegj me zë të ulët:

— Tek eëma.

Filja nuk i tha gjë po u largua me vrap. Dilen nuk e gjeti në shtëpinë e së ëmës. Atëherë mendoi: «Ajo ka shkuar të lindë në pyll.» Padashur i kaluan mornica nëpër trup dhe një pikëllim i madh i rëndoi në zemër. «Në pyll» tha edhe një herë me vete duke u larguar nga shtëpia e familjes së Dilës. Qëndroi. Hodhi sytë dhe pa pyllin. Ai ishte i heshtur, i zi. Retë e ulta



shtrydhnin një shi të imtë e të mërzitshëm mbi të.

Po kjo zgjati vetëm një çast. Filja u shkund dhe u nis drejt pyllit gati me vrap. Këmbët i mbyteshin nëpër gropat e mbushura me ujë, nëpër fytyrë e nëpër tesha i rridhnin pikat e shiu, por ajo nuk qëndronte, ecte gjithnjë përpara. Ekte dhe mendjen e kishte tek Dila. Nuk donte të vonohej. Çdo çast ishte i çmuar. Ajo duhej të arrinte me kohë, duhej ta ndihmonte nusen e re, ta bindte e ta merrte me vete.

Kur u ndodh në prag të pyllit, u ndal. Ja, ishin përballë njëri-tjerit ajo dhe pylli i errët, i lash-të e i ngrysur. Aty brenda tij gratë kishin lindur fëmijët, aty njerëzit e bajraktarit i kishin vrrë babanë në pritë, aty ishin fshehur në vitet e para të pasçlirimit diversantët dhe gjakësorët. Dhe ja, tani ishin përballë njëri-tjetrit ajo dhe pylli. Mendoi një çast nga të drejtohej, pastaj u fut me guxim brenda hijeve. Me sa kishte dëgjuar nga gratë e moshuara, shtatzënët lindnin në një cep të mënjanuar, ku ishin disa gëmusha të larta e të dendura. Filja nuk e dinte me përpikmëri ku ndodhej ai cep, po do ta gjente. Pasi eci mjaft kohë, nisi të thérresë emrin e Dilës, me shpresë që ajo ta dëgjonte dhe t'i përgjigjej. Moti vinte duke u këqësuar. Shpesh errësirën e shqyente shpatë e ndritur e ndonjë rrufeje, kurse thirrjet e saj i mbulonte gjëmimi i përsëritur i bubullimave.

Por ajo vazhdonte të ecte, të kërkonte. Kur në një farë vendi qëndroi një çast për të hequr një drizë që iu ngatërrua në fustan, iu duke sikur dëgjoi një zë. Mbajti vesh. Asgjë. Ashtu i ishte dukur. Atë çast stuhia sikur ishte qetësuar

dhe dëgjoheshin vetëm pikat e shiut që binin nga degët e lagura. Ajo nuk lëvizi. Ja, prapë dëgjoi një zë. U gjallërua menjëherë dhe zemra i rrahu. U nis andej nga vinte zëri. Pas pak dëgjoi edhe një herë zërin që ankohej. Tani nuk kishte më asnje dyshim.

Thirri:

— Dilë!

Përpara vetes iu duk sikur lëvizi diçka.

— Dilë, mos u tremb, jam unë, Filja.

Eci edhe pak dhe u gjend pranë nuses së re.

— Çfarë do? — i tha Dila.

Ajo nuk u përgjegj por e pyeti:

— Si e ndjen veten, Dilë, a mbahesh?

Nusja nuk foli. U bë heshtje. Dëgjohej vetëm ndonjë pikë e vonuar shiu, që zbriste nga degët dhe binte në tokë.

— Çfarë bën këtu, Dilë? — Por e kuptoi se pyetja nuk kishte kuptim dhe shtoi:

— Pse kështu, motër? Pse këtu?

Atëherë Dila, me fjalë të pakë i tregoi si kishte qenë puna. Asaj i kishin filluar dhembjet nga dreka. Në fillim ishte përbajtur, po pastaj nuk kishte duruar dhe kishte thirrur. Atëherë plaku kishte hyrë në dhomë, e kishte shikuar me inat dhe pastaj i kishte folur rëndë. Dilës së gjorë sa nuk i kishte rënë shtëpia mbi kokë. Vjehrri, duke dalë nga dhoma i la dy dyert e shtëpisë të hapura, sikur të donte t'i thoshte: dil prej këndej dhe shko e lind atje ku lindnin gratë përpara, atje ku duhet të lindë çdo grua, sipas kanunit. Atëherë ajo ishte ngritur dhe, duke përbajtur me zor dhembjet, kishte ardhur deri aty. Po bënte tri orë që ishte aty dhe ende nuk ishte liruar.

Filja e dëgjoi pa e ndërprerë dhe u trondit shumë nga fjalët e nuses. E ndjente se përbrenda i ziente një zemërim i madh, por u përbajt dhe nuk foli. E kuptonte se duhej të kishte shumë kujdes, të sillej mirë me gruan shtatzënë, por të ishte e vendosur deri në fund pér t'ja arritur qëllimit.

— Nuk duhet të rrish këtu, — i tha pas pak me zë të butë. — Në pyll është keq, bën të ftohët dhe ka lagështirë. Kështu mund të marrësh në qafë veten dhe foshnjën. Eja me mua!

— Ik, — tha ajo me gjysmë zëri.

— Nuk iki. Ti do të vish me mua. Do të lindësh atje ku duhet.

Dhe duke thënë këto fjalë, i zuri dorën. Dila u drodh, heshti një çast, pastaj tha me zë të lehtë:

— Nuk vij.

— Do të vish. Kjo është pér të mirën tënë dhe të të gjitha grave të tjera. Eja, motër!

Ecëm disa hapa. Dila i hidhte këmbët ngadalë. Pas pak qëndroi dhe tha:

— Nuk vij. Është turp i madh. Kur ta marrin vesh...

— Çfarë turpi, Dilë? Turp të lindësh fëmijë? Këto zakone i ka lënë tek ne kanuni dhe bajraktarët. Ata thoshin se gruaja është kafshë dhe duhet të lindë në pyll, në mes të kafshëve. Por ne do t'i shkulim këto zakone ashtu si barërat e këqia, do t'i shkulim njëherë e përgjithmonë. Eja, Dilë! Këtu bën të ftohët.

U dëgjua një bubullimë e fortë. Pylli ushtoi. Pas pak nisën të trokasin përsëri pikat e shiut. Një vetëtimë shqeu errësirën. Filja shikoi pér

herë të parë fyttyrën e Dilës: ajo ishte e bardhë, pa asnje pikë gjaku. Sytë i ishin zmadhuar dhe buzët e shngjyrosura i mbante të puthitura fort. Files iu drodh zemra kur e pa. Filluan të ecnin më shpejt. Shiu u shpeshua. Pylli ishte i heshtur, i zymtë dhe diçka pëshpëriste me vete.

— Më ngadalë! — thirri Dila.

Qëndruan. Nusja merrte frymë me vështi-rësi.

— Mbahu, Dilë! Edhe pak do të mbrijmë, — e nxiti Filja dhe nisën të ecnin përsëri.

Kur i dolën pyllit ndanë, Dila prapë qën-droi dhe e pyeti shoqen:

— Ku do të më qosh?

— Në shtëpinë e lindjes.

— Atje nuk vij.

— Do të vish!

— Deri tani aty nuk ka shkelur asnje grua e katundit.

— Nuk prish punë. Do të lindësh ti e para.

Ajo vijoi të kundërshtonte, po Filja nuk e zgjati. Kur arritën para shtëpisë së lindjes, Filja trokiti me sa fuqi kishte. Nga brenda nuk dëgjo-hej asnje zhurmë, asnje zë. Ajo trokiti prapë. Pas disa çastesh, u dëgjua një zë i trembur:

— Kush është?

— Hape shpejt, jam unë, Filja.

Mamia pëshpëriti diçka me vete dhe e hapi-derën. Në dritën e një kandili u duk ftyra e përgjumur e Sulltanës.

— Pregatitu për lindje, — tha Filja dhe e shtiu Dilën brenda. Sulltanja në fillim nuk u besoi syve, por pastaj nisi të gjallërohej dhe e çoi

gruan shtatzënë në dhomën e lindjes. Filja e shikoi e habitur. Vuri re se mamia u bë në qejf dhe i luante duart shpejt, duke lëvizur nga një cep i dhomës në tjetrin për të preqatitur sa më mirë lindjen e malësores së re.

Dila lindi vonë, ndaj të gëdhirë. Filja qëndroi aty në dhomën tjetër pa mbyllur sy. Ishte e shqetësuar, pasi Sulltanja i tha se do të lindte me vështirësi. Sillej nëpër dhomë, pastaj qëndronte e mbante vesh. Mendonte pareshtur për Dilën. Sikur asaj ose foshnjës t'i ndodhët gjë, kjo do të thoshte ta mbyllje shtëpinë e lindjes. Prandaj, kur ndaj të gëdhirë mamia hyri në dhomën ku rrinte Filja dhe i tha me fytyrë të qeshur — lindi djalë, — ajo gati sa nuk e përqafoi nga gëzimi. Mori frymë e lehtësuar dhe shkoi tek Dila. Ajo ishte e shtrirë, me fytyrën më të bardhë se çarçafët. Sytë i mbante të mbyllur. Dukej e qetë, dhe në buzët e saja paksa të hapura endej një buzëqeshje e lehtë. Pranë shtratit rrinte foshnja, që qante e cirrej me zërin e tij të hollë por të fuqishëm.

Filja qëndroi disa kohë pa hapur gojë, pastaj i tha Sulltanes:

— Hapi dritaret! Gjithë katundi ta dëgjojë zërin e banorit tonë të ri. Veç kësaj, ta marrë vesh gjithë fshati se u çel shtëpia e lindjes, se këtu sonte u bë lindja e parë. Hapi dritaret!

Pastaj e porositi Sulltanen që t'i thonte Maresë të gatuante gjellë për Dilën dhe doli.

Jashtë ishte bërë ditë. Njeriun e parë që takoi ishte Gjoka, që po shkonte në stallë.

— Mirëmëngjez, File! Ku paske qenë kaq herët?

Ajo i tregoi shkurtimisht ngjarjet e asaj mbrëmjes dhe të natës së kaluar. Gjoka e dëgjoi me vëmendje pa e ndërprerë dhe sytë i ndritën. Ai e donte dhe e çmonte shumë sekretaren e rinisë. Kur ajo mbaroi, ai i tha:

— Të lumtë, File! Ke bërë një punë të madhe.

— Ky është vetëm fillimi. Na mbetet edhe shumë për të bërë.

— E di, por është një fillim i mbarë.

— Pasi vetë po e thua që është fillim i mbarë, unë mendoj që të bëjmë qysh sot një mbledhje me tërë fshatin dhe ta marrim për shembull punën e Dilës. Në këtë mënyrë edhe ja myllim gojën ndonjë njeriu të keq, edhe do të ndihmojmë që gra të tjera në të ardhmen të veprojnë si Dila.

Gjoka u mendua, pastaj tha:

— Mirë, jam i një mendjes me ty. Shko e fol me Gjonin!

— Atje jam nisur. Mirë u pafshim!

Në zyrën e kryetarit, Filja gjet disa blegtore, që kishin ardhur për punën e stallës së re. Ajo shkoi pranë dritaresh, dhe mendjen nuk e kishte tek biseda e tyre po te Dila. I kujtohej fytyra e saj e bardhë, e lodhur dhe ajo buzëqeshje që i endej mbi buzët paksa të hapura.

— Hë, File, si është puna? — u dëgjua, pas saj zëri i Gjonit.

Ajo u kthye. Blegtoret kishin ikur. I tregoi Gjonit fill e për pe ç'kishte ngjarë dhe i tha përmbledhjen.

— Këtu e prishe, — tha kryetari. — Sonte kemi punë të tjera. Mbledhjen e lëmë për ndonjë ditë tjetër.

— Jo, do ta bëjmë sonte. Hekuri do rrahur sa është i nxehjtë.

— Dëgjo, File ...

— Në çfarë ore t'i lajmërojmë kooperativistët?

Gjoni e shikoi, heshti, pastaj vuri buzën në gaz:

— Lajmëroi për në orën gjashtë!

Kur doli jashtë, Filja qëndroi tek shkallët e kryesisë. Ktheu kokën dhe shikoi shtëpinë e lindjes. Vuri re se oxhaku ishte ndezur dhe prej tij drejt qellit lartohej një fill tymi i kaltër!

«Nënë Mara po gatuan gjellën për lehonën e parë të shtëpisë së lindjes» mendoi Filja.

Mori frymë thellë dhe u nis për në punë.

PERBALLË KISHA BUZEQESHJEN E NJEREZVE

U bënë disa javë që kisha ardhur në qytetin e vogël N. Kam nisur punën, jam vendsur në një apartament të ri dhe çdo gjë po më vete mbarë. Boshllëku prej më se njëzet vjetësh në mes meje dhe njerëzve e qytetit ku linda, punova e luftova, ka nisur të mbushet.

Dua t'ju flas për ditën e parë kur erdha këtu. Mendova se ja vlen barra qiranë. Ju dëgjeni dhë ma merr mendja se do të më jepni të drejtë.

Në qytetin N. erdha një mbrëmje janari. U nisëm nga Tirana në orën tetë por rruga ishte e gjatë dhe mbërrijtëm pasdite vonë. Gjatë rrugës fola shumë pak. Kur udhëtoj, më pëlqen më shumë të shikoj dhe të mendoj. Ashtu bëra edhe atë ditë. Shikoja dhe mendoja. Kisha plot gjëra për të menduar.

Transferimi nga ministria më erdhi i papritur, megjithëse plot shokë të tjerë kishin shkuar në bazë. Të them të drejtën nuk më erdhi mirë që më caktuan me punë pikërisht në qytetin

tim të lindjes. Do kisha dashur më mirë të shkoja diku tjetër.

Rruga m'u duk e gjatë. Gjatë viteve të pasçlirimit kisha udhëtar jashtë shtetit dhe në katër anët e vendit tonë, kurse në qytetin e vogël buzë lumit nuk di të kisha shkuar më shumë se dy-tri herë. E mbaj mend se një herë kam qënë për të festuar përvjetorin e krijimit të brigadës sonë dhe një herë tjetër kur mora pjesë në një mbledhje që zgjati një gjysmë dite. Në të dy rastet nuk pata qëndruar më shumë se disa orë.

Pa e kuptuar isha shkëputur fare nga ai qytet dhe isha bërë si i huaj me njerëzit e tij. Por sa mbaroi lufta, u vendosa në Tiranë, krijuva familje dhe nisa punën. Më vonë punova në disa rrrethe të tjera. Pastaj erdhën vitet e shkollës jashtë shtetit dhe së fundi puna në ministri, ku kisha zënë vend prej gjashtë vjetësh. Natyrisht kisha dëgjuar e lexuar për qytetin tim, e dija se ai kishte ndërruar fytyrë, e dija se atje ishte ndërtuar një uzinë e madhe, e cila i kishte dhënë tjetër gjallëri dhe një ritëm të ri jetës së qytetit. Ngandonjëherë isha takuar në Tiranë ose gjetiu me ndonjë nga bashkëqytetarët e mi por t'ju them të drejtën pak gjëra dija për njerëzit, për rruget e tyre në jetë, për familjet e tyre.


Duke udhëtar mendoja që gjatë atyre viteve kisha qëndruar kaq i shkëputur nga njerëzit e mi, që dikur i kisha patur aq afër, nga shokët e fëminisë e të luftës me të cilët isha endur maleve, kisha fjetur nën një kapotë dhe kisha ndarë kafshatën dhe fishekët e fundit. Në vitet e para të pas luftës disa më shkruanin dhe unë u kthe-

ja përgjegje. Ato letra më mbanin të lidhur me vendin e lindjes dhe, pas rreshtave të tyre, ndiqja jetën e qytetit të vogël dhe rrugët e reja në për të cilat ecnin njerëzit e tij. Edhe të tjerë më shkruanin për të më kërkuar ndonjë nder, për të më qarë ndonjë hall duke m'u lutur që t'i ndihmoja, të pyesja ose të ndërhyja. Në fillim nuk u kurseva po pastaj isha i zënë me punë dhe të gjithë nuk i kënaqja dot. Letrat filluan të vijnë më rrallë, derisa reshtën fare. Më vonë, siç thashë, shkova në rrethe të tjera, dola jashtë shtetit për studime dhe të gjitha lidhjet u prenë.

Këto gjëra sillja nëpër kokë gjatë udhëtimit dhe ato më bënë të mendohem. Si do më pritnin bashkëqytetarët e mi, shokët e dikurshëm? Çdo të thoshin ata për ftohtësinë time? Ja, këto ishin arësyet që nuk më erdhi mirë kur më caktuan drejtor të asaj uzine të madhe pikërisht në qytetin tim.

Duhet të shtoj edhe diçka tjetër dhe këtë vetëm tani mund ta them pa u ndrojtur fare. Duke qëndruar vazhdimi i myllur nëpër zyra, i zënë me punë, gjithnjë në një vend, isha larguar përgjithësisht ngajeta e gjallë dhe nga njerrëzit. Rrija pak me ta, kisha dy-tre shokë të punës dhe, pa e kuptuar, isha kthyer në një farë mizantropi. Kjo gjë kishte ndodhur ngadalë e shkallë-shkallë. Atëhere këtë nuk e kuptoja dhe nuk do ta pranoja po të ma thoshte njeri. Kurse tani e pranoj.

Gjatë udhëtimit pejsazhi nuk më tërhoqi. Vetëm pasi dolëm nga rruga kryesore dhe hymë në një rrugë ende të paasfaltuar vende-vende, zuri



të më zgjohej interes i se ishim në afërsi të qytetit tim. Ato vende ishin të dashura, të afërta përmua, të mbushura me kujtime. Ja, tek kjo urë e gurtë, kur ishim fëmijë, vinim dhe znim peshk. Tek ajo gryka atje i zumë pritë një kolone italiane. Tek ato shtëpi në këmbë të kodrës kemi bujtur një natë pas betejës dhe aty lamë një shok të plagosur rëndë.

Zuri të errej. Muzgu i shkurtër i dimrit u shua menjëherë dhe ja lëshoi vendin mbrëmjes. Moti ishte i vrenjtur, i qetë dhe nuk frynte erë. Autobusi kaloi para uzinës ku do të punoja. Shikova më interesim vendin e ri të punës, megjithëse konturet ja njihja më kohë nga gazetat. Ishin disa korpusë të gjata me shumë dritare dhe mbi ta ngrihej madhështor një oxhak i madh, i cili lëshonte pareshtur tym të zi që ngjitej e trejtë mbi retë e ulëta të mbledhura në qzell.

— Mbërrijtëm! — tha plaku që kisha pranë, me të cilin kisha folur shumë pak gjatë tërë rrugës.

Autobusi mori edhe kthesën e fundit dhe pas pak u shfaq një lugine e madhe dhe u dukën dritat e qytetit.

Qëndruam te posta. Zbrita dhe ndënja disa çaste në mes të rrugës duke menduar ku të shkoja.

Rruja zhurmonte nga njerëzit. Një pjesë prej tyre ishin të rinj. Siç duket ishin punëtorë dhe teknikë të uzinës së madhe. Asfalti ndriçonte si një pasqyrë e zezë. Në dy anët ngriheshin ndërtesa të reja, ndonjëra ende e papërfunduar. Në

një dyqan të ndriçuar më shumë se të tjerët hy-nin e dilnin njerëz pareshtur. Lexova tabelën: ishte MAPO. Në fund të rrugës ngrivej shtëpia e kulturës dhe kinemaja. Ndonja dyqind metra në të djathtë ishte hoteli dhe restoranti. Mbërtëveva pardesynë, mora valixhen dhe u nisa drejt hotelit. Pa dashje më pushtoi një ndjenjë e çuditshme, më dukej vetja si një njeri i huaj në një qytet të huaj. Nga gjithë ata të rinx që shikoja nuk njihja asnjerin se, ose ishin të ardhur, ose djem që ishin rritur e unë nuk i kisha parë ku-rrë. Edhe nga njerëzit që hynin e dilnin nga MAPO e dyqanet e tjera m'u duk sikur nuk njihja njeri.

Në hyrje të hotelit u takova ballë për ballë me një oficer. Shikuam njëri-tjetrin. M'u duk ftyrë e njojur. Po cili ishte?

— Tungjatjeta, Milto, — më përshëndeti ai.

— Tungjatjeta, — iu përgjegja unë. Nuk më kujtohej emri i tij. Më erdhi në mend që kishim banuar në një lagje, edhe në shkollë kishim qenë bashkë, por emri i tij nuk më kujtohej fare.

— Kam marrë vesh se je transferuar këtu,
— më tha ai.

— Po.

— Shumë mirë. U ktheve prapë te ne. Sa kohë ke pa ardhur?

— Kam... disa kohë.

Një burrë me një pallto ushtarake kaloi para meje për të hyrë në hotel dhe i tha oficerit:

— Mirëmbrëma, Sulo!

Ah, po, ai ishte Sulo Zeqiri, djali i Hysniut,

atij pemëshitësit të lagjes sonë. Si nuk m'u kuj-tua më parë?

— Po ç'bën këtu, Sulo, je me shërbim?

— Po, këtu e kam repartin, në periferi të qytetit. U enda shumë vite në zona të ndryshme dhe tani u ktheva në vendlindje.

E vështrova: ai ishte plakur, megjithëse ende nuk kishte mbushur të pesëdhjetat. Flokët i kishte fare të zbardhura. Vetëm sytë i kishte gjithnjë të rinj.

— Do kisha ndenjur të bisedojmë, po kam prerë bileta për të vajtur në kinema bashkë me gruan. Megjithatë tani do kemi rast të takohemi. Natën e mirë!

— Natën e mirë, Sulo!

Në sportel ishte një grua me fytyrë të gjatë, që dukej si e përgjumur. Më tha:

— Nuk kam asnjë shtrat të lirë. Presim një ekip të Kryeministrisë. Na kanë lajmëruar para dy ditësh. Po nuk erdhën, do ju jap një shtrat. Dukuni më vonë.

Ku të shkoja? Po sikur ekipi të vinte. Nuk më vinte mirë të flija tek disa kushërinj se me ta isha ftohur prej kohe.

Mora valixhen dhe hyra në bufe. Në të djath-të të hyrjes ishte një banak i gjatë kurse përballtij lokal i mbushur plot e përplot me njerëz. Aty bëhej zhurmë dhe të gjithë bisedonin ose qesh-nin. Në tërë lokalit dëgjohej një zukatje e pandërprerë. Një kamariere e gjatë, me flokë të dendura sillej pareshtur nëpër sallë duke kaluar nga një tryezë në tjetrën.

Ndërsa kërkoja me sy ndonjë vend të lirë, një zë u ngrit mbi zukatjen e përgjithshme të sallës dhe thirri:

— O Milto!

M'u duk se zëri vinte nga e majta, disa tryenza përtej hyrjes. Ktheva kokën. Pashë një burrë të ngjallur me kasketë që ishte ngritur më këmbë dhe ma bënte me dorë. E njoha menjëherë: ishte Sokrati.

U nisa drejt tij.

— Hajde, or byrazer, ku je? — tha Sokrati dhe m'u hodh në qafë, pastaj më bëri një vend në tryezën ku po rrinte me dy njerëz që nuk i njihja.

— Kur erdhe? — më pyeti ai pa u ulur mirë.

— Tani sa mbërrita.

— Kemi disa ditë që e morëm vesh transferimin tënd. U gjëzuam shumë. U bë goxha kohë pa u parë, or byrazer.

M'u kujtua se e kisha takuar një herë Sokratin në një kongres po nuk e mbaja mend në ç'vit. Kishim shkëmbyer disa fjalë të përgjithshme. Asgjë më tepër.

— Ku punon tani, Sokrat? — e pyeta.

— Jam kryetar kooperative në një fshat pranë qytetit. U bënë gjashtë muaj që u largova nga qyteti me dëshirën time dhe jam atje.

Ndërsa ai fliste, unë rrija dhe e vështroja. Ish-te ndyshuar dhe ishte ngjallur. Në fëmini kishte qenë i hollë madje shëndetlig, kurse tani dukej tërë gjallëri e shëndet. Fliste me zë të lartë duke lëvizur pareshtur duart.

Pasi më tregoi për vete dhe më bëri edhe mua disa pyetje, Sokrati më njoihu me dy shokët e tjerë, që rrinin në një tryezë me ne: njëri prej tyre, një djalë me fytyrë të mprehtë e lëkurëbardhë ishte kryeagronomi i rrethit, kurse tjetri, një burrë shulak, me fytyrë të pjekur nga dielli, kryetar i një kooperative bujqësore.

— Siç e sheh jemi të tre pjesëtarë të familjes së madhe të bujqësisë, — tha në fund Sokrati dhe zuri të qeshë.

Pas prezantimit biseda u bë më e gjallë dhe të tre më folën për përparimet që kishte bërë bujqësia në rrëth, si kishin avancuar planet dhe si po ndryshonte çdo vit jeta e fshatarëve. Ata përmendnin emra fshatash që i njihja, se gjatë luftës i kisha shkelur të gjitha.

Papritmas biseda u ndërpre. Sokrati u ngrit më këmbë dhe thirri:

— O Sabri! O Koço!

Dhe pasi u kthyte nga unë tha:

— Shiko kush po vjen!

Pranë tryezës sonë u avitën dy burra. U përshëndetëm. Me Sabriun kisha qenë partizan në një batalion, kurse me Koçon kishim ndenjur në një bangë gjatë viteve të shkollës.

Sokrati gjeti dy karrige të tjera dhe ata zunë vend pranë nesh. Duke biseduar me ta, mora vesh se Koçoja ishte mjek në spitalin e qytetit, kurse Sabriu ishte drejtor i kantinës së verës.

— Kur të duash shkojmë e i bëjmë një vizitë Sabriut, — tha Sokrati, — vetëm ka një të keqë që do të shkojmë me këmbët tonë e do na kthejnë në shtëpi për krahësh.

Plasi gazi. Vura re se Koçoja nuk qeshi por vetëm bëri buzën në gaz. Edhe kur u takuam më bëri përshtypje qëndrimi i tij.

Pas pak Koçoja m'u kthyte e më tha:

— Kam ardhur nja dy herë të të takoj në Tiranë.

Në fjalët e tij ndjeva një qortim. E kuptova menjëherë, se ai do më thoshte diçka të thartë. Dhe vërtet, pas atyre fjalëve ai shtoi:

— Herën e parë nuk ishe aty. Kurse herën e dytë më tha sekretari se ishe i zënë dhe nuk mund të më prisje.

E ndjeva veten keq. Nuk dija ç'ti thosha. M'u duk se të gjithë më vështronin dhe ndoshta edhe ata përveç Koços, kishin patur ndonjë rast të ngashëm me atë që i kishte ngjarë mjekut.

— Ndoshta... — belbëzova pa ditur çfarë të thosha, — kushedi si ka qëlluar puna, ju e kuptoni...

U bë një pushim. Askush nuk fliste. Kryeagronomi dhe kryetari i kooperativës u ngritën, pasi e kuptuan që ishin të tepërt.

Në bufe vinte zhurma dhe njerëz të ndryshëm hynin e dilnin pa pushim. Kamerierja e gjatë me flokë të dendura shkonte nga një tryezë në tjetrën.

— Ja, erdhi edhe përgjegjësi — tha Sokrati.

Ktheva kokën nga hyrja. Në derë rrinte Flamuri. Ai na pa dhe zuri të ecë drejt nesh. Po pse mbante shkop dhe çapitesh me vështirësi?

Më njobu menjëherë dhe duke picërruar sytë e ëmbël gështenjë, thirri:

— Si je, Milto, vëlla? — dhe më përqafoi me zjarr.

U mallëngjeva shumë kur u takova me të. Ishte shoku ëm më i dashur i fëminisë. Pastaj, gjatë gjithë luftës, kishim luftuar krah pér krah. Kur u plagosa në sup, Flamuri nuk m'u nda asnë çast dhe tërë rrugës nga beteja deri në bazë më mbajti në krah dhe net me radhë nuk mbylli sy duke qëndruar pranë meje. Kisha pyetur disa herë pér të. Më thanë se punonte në një hidrocentral. Më vonë prapë më thanë se punonte në një hidrocentral tjetër.

Ai u ul duke mbajtur shkopin në mes të këmbëve. Vura re se këmbën e djathtë e mbante të shtrirë përpara pa e thyer gjurin. Ishte pak i verdhë në fytyrë dhe flokët i kishin rënë, duke i lënë zbuluar një ballë të lartë e të ndritur. Më erdhi shumë keq që kishte mbetur pa këmbë, dhe nuk dija si ta pyesja. Më ndihmoi Sabriu:

— E ke marrë vesh punën e Flamurit?

Tunda kokën.

— E ka këputur këmbën duke hapur një galeri në hidrocentral. Aksident pune.

Vura re se Flamuri e ndjeu veten ngush-të. Unë e njihja mirë: ai nuk donte që të flitej pér të. Gjithmonë kishte qenë i tillë: modest, fjalëpaktë e njeri i sakrificës.

— Si ja çon me punë, a je mirë?

— Shumë mirë. Nuk kam ndonjë punë kushti se çfarë, megjithatë nuk ankohem.

— Ky nuk duhet të punojë se është invalid,

— ndërhyri Sokrati, — po ku i rrihet këtij, o

byrazer. Shkoi e bëri një alamet shamate dhe kërroi me zor t'i caktonin një punë. Atëhere s'pat-tën çfarë të bëjnë dhe e vunë përgjegjës të hotelit.

Prapë Flamuri nuk e ndjeu veten mirë, madje m'u duk se u skuq dhe nisi të flasë për diçka tjetër. C'njeri i mrekullueshëm ishte ai! E sa të tillë ka në të katër anët e vendit tonë, në qytete e fshatra. Ne ata i shohim duke kaluar rrugës, rrijmë me ta, dhe shpesh nuk e dimë sa shpirt të madh që kanë dhe çfarë vazhde të ndritsh-me lënë pas vetes.

Me radhë biseduam për jetën e qytetit gjatë atyre viteve, për ndryshimet, për perspektivën e tij. I pyeta për shokët e për të njojurit e tjerë dhe ata më treguan. Njëri punonte në një kantier të madh, një tjetër ishte oficer në kufi, një i tretë kishte vdekur, dikush ishte teknik në uzinë, kurse një tjetër punonte në një ambasadë jashtë shtetit. Biseda ishte e ngrohtë, e përzemërt dhe unë mësova shumë gjëra që më parë nuk i dija. Ata harruan vitet që na ndanin, harruan (apo bënë sikur harruan) gabimet e mia, ftohtësinë time. Edhe Koçua u çel, fliste me gjallëri dhe më shikonte buzëgaz me ata sytë e tij të vegjël. Biseda hidhej nga një temë në tjetrën dhe brenda pak minutave kapërcenim nëpër vite, prapë ktheshim tek e sotshmja, prapë zhyteshim në kohën e kaluar.

— A ju kujtohet kur e arrestuan Sokratin? — tha Sabriu dhe ne qeshëm, se ajo ishte një histori gazmore. Megjithatë kërkua që ai të na tregonte si ua hodhi italianëve.

— Dhe që thoni ju, or byrazera... nisi të tre-gjë Sokrati.

Unë dëgjoja Sokratin dhe me radhë shikoja shokët. Ja, Sabriu, Koçoja, Flamuri... Herë pas here sytë e mi takoheshin me ato të Flamurit. Përsëri m'u kujtua plagosja, kur ai më barti në krah dhe pastaj përgjoi net të tëra sa më kaloi rreziku. Ai nuk ishte shok dosido, por shok i dashur i fëminisë dhe pastaj shok lufte. Prandaj më ishte vëlla e shkuar vëllait. Edhe të tjerët të tillë ishin. Si kisha mundur t'i harroja, të rrija larg tyre kaq vite? Ata sigurisht mblidheshin shpesh, bisedonin, ndoshta më kishin zënë edhe mua në gojë... Të gjithë ishin të lidhur me mijëra fije të ndryshme me jetën e gjallë, me njërezit. Kështu bënte Sabriu. Koçoja, Sokrati që kishte lënë qytetin dhe tani endej nëpër fushat e gjera të kooperativës, duke thithur kundërmimin e shëndetshëm të dheut. Edhe Flamuri, që ishte endur nga një hidrocentral në tjetrin duke punuar me njërez të mrekullueshëm, sot nuk pranonte të rrinte rehat, të kishte një qoshe të nxeh-të, të shullëhej në stolat e lulishteve. Ata kishin jetuar dhe prapë jetonin në mënyrë intensive, përpinqeshin, luftonin dhe ishin të lumtur e të këna-qur. Kurse unë, pse ta fsheh, më parë kuschedi ç'ë pandehja veten... Ç'kisha më shumë se ata? Asgjë. Bashkë u rritëm, bashkë luftuam dhe tani punonim: unë në një vend, Koçoja, Sabriu Flamuri e Sokrati në vende të tjera, por të gjithë bënim punë të dobishme e të nderuara.

Ata flisnin dhe unë mendoja. Kujtimet e luftës ndoqën njëri-tjetrin. Secili kishte diçka për

të treguar. Pikërisht kujtimi i atyre viteve të stuhishme më bëri të shoh më thellë në veten time. Që atë çast nisa të kuptoj se ardhja ime në këtë qytet të vogël ishte një gjë shumë e mirë, nga e cila do të përfitoja sidomos unë, se do të gjeja atë pjesë të vetes sime që pa dashur e kisha lënë në hije...

Pastaj nuk e di se cili nga ne zuri të këndo-jë një këngë. Kush qe, Koçoja, Flamuri, Sabriu apo Sokrati? Nuk më kujtohet. Nejse, kjo nuk ka rëndësi. Ishte një këngë partizane, e shtruar, e ndjerë.

Në fillim kënduam nën zë por pastaj zërat tonë u ngritën, u bashkuan me njëri-tjetrin dhe kënga buçiti e fortë.

Njerëzit e lokalit ktheyen kokën. Nuk duke-shin të çuditur. Na shikuan buzëgaz.

Këndoja me gjithë shpirt. Isha i ngashëryer e zëri ndoshta më dridhej, po ashtu i bashkuar me zërat e shokëve të tjerë nuk dallohej ajo dridhje e lehtë. Këndoja ashtu si dikur, në mes të shokëve, krah për krah me shokët dhe përballë kisha buzëqeshjen e njerëzve.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

1) Atë natë brodha rrugëve	3
2) Muzikë nate	16
3) Do të flas edhe unë...	29
4) Në dy anë të trasesë	42
5) Një zë nga rrugica	54
6) Kamjona përtej kufirit	67
7) Në hyrje të pyllit	80
8) Lindja e parë	92
9) Përballë kisha buzëqeshjen e njerëzve	109